

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI MASTER: PEDAGOGJI E PËRGJITHSHME**



**TEZA MASTER**

**Veçantitë e organizimit dhe menaxhimi i mësimit në klasë dhe mësimit në distancë në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet**

Mentori/ja:

Prof. Dr. Sc. Demë Hoti

Kandidati/ja:

Fitore Bërbatovci Morina

*Prishtinë, Dhjetor, 2021*

© [2021]-[Fitore Bërbatovci] Të gjitha të drejtat të rezervuara.

## ABSTRAKTI

Ky hulumtim ka për qëllim që të analizoj veçantitë dhe karakteristikat e organizimit dhe menaxhimit të mësimit në klasë dhe mësimit në distancë në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet në shkollat fillore. Qëllimi i hulumtimit është evidentimi i ngjajshmërive dhe dallimeve.

E drejta për arsimim është e drejtë universale e çdo fëmije, kështu që, si në procesin e rregullt arsimor ashtu edhe në të gjitha modelet e tjera të mësimdhënies, duhet të merret parasysh dhe të garantohet se si modeli i mësimit në klasë po ashtu edhe modeli i mësimit në distancë të përshtatet në mënyrë të barabartë dhe të jetë i arritshëm për çdo nxënës. Kjo do të thotë që gjatë krijimit të tij, duhet të merren parasysh kushtet, teknike dhe sociale, mundësitë dhe nevojat e nxënësit, si dhe rreziku nga thellimi i hendekut shoqëror midis nxënësve, dhe veçanërisht duhet kushtuar vëmendje situatës në të cilën gjenden fëmijët nga kategoritë e rrezikuara sociale dhe me më pak mundësi.

Çdo mësimdhënës në të vërtetë ka nevojë për hartimin e një plani të mirëorganizuar dhe për menaxhim të mësimit në klasë dhe mësimit në distancë, të përbërë nga një kombinim teorish apo modelesh të caktuara të cilat mund t'i aplikojë me nxënësit në shkollat fillore. Menaxhimi është i lidhur drejtpërsëdrejti me organizimin e gjithçkaje jo vetëm të elementeve kurrikulare duke përfshirë aspektin kohor, mjedisin fizik, materialet e ndryshme, rutinat e përditshme, përfshirjen dhe angazhimin e nxënësve, disiplinën, sjelljet problematike, etj. Zbatimi i një filozofie individuale menaxhimi nga mësimdhënësi me nxënësit e nivelit fillor në fillimet e një viti shkollor padyshim e ndihmon atë në ecurinë e parashikueshmërinë e tërë procesit mësimor gjatë vitit, si në mësimin në klasë poashtu edhe në mësimin në distancë.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të kuptohen dhe të identifikohen ngjajshmëritë dhe dallimet e mësimit në klasë dhe mësimit në distancë. Ky vlerësim lehtëson punën e hulumtimit të realizuar për identifikimin e ngjajshmërive dhe dallimeve të këtij fenomeni. Në hulumtim përfshihen mësimdhënës, prindër dhe nxënës në shkollimin fillor.

***Fjalët kyçe janë:*** Menaxhimi, mësimi në klasë, mësimi në distancë, organizimi, shkolla fillore.

## ABSTRACT

This research aims to analyze the peculiarities and characteristics of the organization and management of classroom learning and distance learning in primary schools-similarities and differences in primary schools. The purpose of the research is to identify similarities and differences.

The right to education is a universal right of every child, so, both in the regular educational process and in all other teaching models, both the classroom learning model and the model must be taken into account and guaranteed of distance learning to fit equally and be accessible to every student. This means that when creating it, the conditions, technical and social, opportunities and needs of the student should be taken into account, as well as the risk of deepening the social gap between students, and special attention should be paid to the situation in which children from the categories are socially vulnerable and with fewer opportunities.

Every teacher really needs to design a well-organized plan and to manage classroom and distance learning, consisting of a combination of certain theories or models that he can apply with students in elementary schools. Management is directly related to the organization of everything not only curricular elements including time aspect, physical environment, various materials, daily routines, involvement and engagement of students, discipline, problem behaviors, etc. The implementation of an individual management philosophy by the teacher with primary school students at the beginning of a school year undoubtedly helps him in the performance and predictability of the entire learning process during the year, both in classroom and distance learning.

The main purpose of this research is to understand and identify the similarities and differences between classroom learning and distance learning. This assessment facilitates the work of research conducted to identify the similarities and differences of this phenomenon. The research includes teachers, parents and students in primary school.

***Keywords:*** Management, classroom learning, distance learning, organization, elementary school.

## **DEDIKIMI**

*Punimin tim ua dedikoj prindërve të mi dhe bashkëshortit Fitimit.*

*Respekt, dashuri dhe mirënjohje të pa fund!*

## **FALËNDERIMI**

Përfitoj nëpërmjet kësaj hapësire të vogël të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen personave, të cilët më kanë mbështetur në realizimin e këtij punimi.

Së pari, dëshiroj të falënderoj udhëheqësin tim, prof. Dr. Sc. Demë Hoti, për të gjitha sugjerimet, vërejtjet dhe çdo orë të kohës së tij, për të arritur një finalizim sa më të mirë.

Falënderim të veçantë kam për bashkëshortin tim Fitimin dhe fëmijët e mi Ferozen dhe Fronin, të cilët kanë qenë motivi më i madh për të përfunduar këtë studim dhe të cilët nuk u kursyen në asnjë moment për përkrahje maksimale në çdo aspekt.

# PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI.....	3
ABSTRACT .....	4
Lista e tabelave .....	5
Lista e figurave .....	6
I. HYRJE .....	2
Qëllimi i hulumtimit .....	4
Pyetjet e hulumtimit .....	4
Hipotezat e hulumtimit .....	4
II. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	5
2 Organizimi i mësimi si vepimtari .....	5
a. Ndikimi i teknologjisë në organizimin e mësimi .....	7
b. Modaliteti - ecuritë e realizimit të tij në procesin e mësimi në klasë.....	9
1. Çfarë kuptojmë me menaxhimin e mësimi në mjedisin e klasës?.....	13
2. Përkufizime rreth termit të menaxhimit të mësimi në klasë .....	17
3. Menaxhimi dhe disiplina e mësimi në klasë .....	19

c. Mësimi në distancë, baza filozofike e pedagogjike .....	21
1. Modalitet e organizimit të mësimi në distancë .....	23
2. Specifikat e organizimit dhe realizimit të mësimi në distancë.....	30
3. Programet për mësimin në distancë .....	30
2.6 Rëndësia e të nxënit nga mësimi në distancë.....	32
2.7 Epërsitë dhe mangësitë e të mësuarit në distancë .....	33
2.7.1 Epërsitë që ofron mësimi në distancë: .....	34
2.7.2 Mangësitë e të mësuarit në distancë: .....	35
2.7.3 Sfidat e menaxhimit të arsimit me mësimnxënie nga distanca.....	36
2.7.4 Vështirësitë në qasjet teknologjike .....	37
2.7.5 Problemet gjatë mësimi në distancë.....	38
2.7.6 Vështirësitë e mësimdhënësit .....	39
III. PLATFORMA E MËSIMIT NË DISTANCË .....	41
3.1 Platformat teknologjike të mësimi në distancë.....	41
3.2 Google Classroom.....	46
3.3 MEET .....	47
3.4 Skype .....	47
3.5 Posta elektronike.....	48
3.6 ZOOM .....	48



IV METODOLOGJIA .....	50
4.1 Popullacioni dhe mostra e hulumtimit .....	50
4.2 Instrumentet e hulumtimit .....	50
4.3 Procedurat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave .....	51
4.4 Rezultatet e pritura .....	51
V ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET .....	52
5.1 Analiza deskriptive e të dhënave demografike të mësimdhënësve .....	52
5.2 Analiza deskriptive e të dhënave demografike të prindërve .....	57
5.3 Analiza deskriptive e të dhënave demografike të nxënësve .....	62
5.4 Analiza e besueshmërisë së pyetësorit të mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve ....	67
VI DISKUTIMI .....	71
VII PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET .....	73
7.1 Aspekti etik .....	75
7.2 Kufizimet në hulumtim .....	75
REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE .....	76
SHTOJCA – 1: Pytësori për mësimdhënësit .....	80
SHTOJCA – 2: Pytësori për prindërit .....	82
SHTOJCA – 3: Pytësori për nxënësit .....	84

## Lista e tabelave

<b>Tabela 1.</b> Analiza deskriptive e të dhënave demografike të mësimit në distancë.....	52
<b>Tabela 2.</b> Analiza deskriptive e të dhënave demografike të prindërve .....	57
<b>Tabela 3.</b> Analiza deskriptive e të dhënave demografike të nxënësve.....	62
<b>Tabela 4.</b> Cronbach's Alpha.....	67
<b>Tabela 5.</b> Menaxhimi i mësimit në distancë dallon shumë nga menaxhimi i mësimit në klasë.....	67
<b>Tabela 6.</b> Mësimit në distancë nuk janë të aftësuar mjaftueshëm para shërbimit për zbatimin e mësimit në distancë. ....	68
<b>Tabela 7.</b> Nxënësve iu mungojnë shkathtësitë e nevojshme për zbatimin e mësimit në distancë. ....	69
<b>Tabela 8.</b> Analiza e One-Way Anova mbi dallimet në mes të shkollave lidhur me vendbanimin urban dhe rural .....	70

## Lista e figurave

<b>Figura 1.</b> Klasat në të cilat japin mësim mësimdhënësit.....	53
<b>Figura 2.</b> Preferenca e mësimdhënësve lidhur me mësimin në klasë dhe mësimin në distancë...	54
<b>Figura 3.</b> Menaxhimi më i lehtë i ores mësimore nga mësimdhënësit.....	54
<b>Figura 4.</b> Vështirësitë e mësimdhënësve lidhur me përdorimin e mjeteve teknologjike gjatë mësimin në distancë.....	55
<b>Figura 5.</b> Vështirësitë në vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë.....	55
<b>Figura 6.</b> Njohuritë e mësimdhënësve për programet që mundësojnë mësimin në distancë .....	56
<b>Figura 7.</b> Të dhënat për nxënësit se sa kanë ndjekur mësimin në distancë .....	56
<b>Figura 8.</b> Klasa në të cilën vijojnë mësimin fëmijet e prindërve të anketuar .....	58
<b>Figura 9.</b> Metoda e mësimdhënies të cilën prindërit e preferojnë për fëmijet e tyre .....	58
<b>Figura 10.</b> Problemet e prindërve për të siguruar pajisjet teknologjike që fëmijet e tyre të ndjekin mësimin në distancë .....	59
<b>Figura 11.</b> Vështirësitë e fëmijëve në përdorimin e pajisjeve teknologjike të cilat mundësojnë mësimin në distancë. ....	59
<b>Figura 12.</b> Vështirësitë e fëmijëve për tu adaptuar me mësimin në distancë sipas përgjigjeve të prindërve.....	60
<b>Figura 13.</b> Vlerësimi i prindërve lidhur me menaxhimin e ores mësimore në distancë nga mësimdhënësi. ....	60
<b>Figura 14.</b> Mendimet e prindërve mbi vlerësimin e fëmijëve nga mësimdhënësit gjatë mësimin në distancë.....	61
<b>Figura 15.</b> Të dhënat e nxënësve se a e preferojnë më shumë mësimin në klasë apo në distancë. ....	63
<b>Figura 16.</b> Problemet e nxënësve me përdorimin e pajisjeve teknologjike që mundësojnë mësimin në distancë. ....	63
<b>Figura 17.</b> Njohuritë e nxënësve për programet që mundësojnë mbajtjen e mësimin në distancë. ....	64
<b>Figura 18.</b> Menaxhimi i ores gjatë mësimin në distancë sfidë për mësimdhënësit .....	64
<b>Figura 19.</b> Vështirësitë e nxënësve për tu adaptuar me mësimin në distancë. ....	65
<b>Figura 20.</b> Kënaqësia mbi vlerësimin që mësimdhënësit e kanë dhënë për nxënësit e anketuar. 65	
<b>Figura 21.</b> Nxënësit shprehin dëshirën e tyre mbi mënyrën e ndjekjes së mësimin që ata dëshirojnë. ....	66

## I. HYRJE

Organizimi dhe menaxhimi i mësimit në klasë dhe mësimit në distancë përbën një ndër problematikat më të shpeshta me të cilat përballen mësime të gjeneratave aktuale të nxënësve në nivelin fillor. Organizimi dhe menaxhimi i mësimit në klasë dhe mësimit në distancë vazhdimisht është identifikuar si një element parësor jo vetëm në të nxënësit e nxënësve por dhe në mbarëvajtjen e procesit të mësimit në sistemin fillor, në të cilin është fokusuar dhe ky punim. Edhe pse rëndësia e kësaj teme njihet tashmë në mënyrë universale sërish nuk mund të themi që kjo çështje ka fituar “pavarësinë” për t’u trajtuar si e tillë bazuar në të dhëna konkrete, empirike të përftuara nga vëzhgimi, studimi e analizimi i situatave të ndryshme problematike me të cilat përballen mësime të gjeneratave aktuale me organizimin dhe menaxhimin e mësimit në klasë dhe mësimit në distancë.

Përgjatë këtij punimi do të hulumtohen metodat më efektive që rezultojnë në përgjigjet e pyetjeve të hulumtimit. Duke parë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e adaptimit me mësimin në distancë kam vendosur të hulumtojë më shumë në këtë fushë, dhe të gjejë përveç mendimeve të mësime të gjeneratave aktuale edhe mendimet e prindërve dhe të nxënësve në lidhje me këtë temë. Menaxhimi i mësimit në klasë dhe mësimit në distancë për momentin janë temat më të diskutueshme në shoqërinë tonë dhe për këtë arsye kam vendosur ta hulumtoj.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të sintetizojë literaturën në dispozicion dhe të identifikojë veçantitë e organizimit dhe menaxhimit të mësimit në klasë dhe mësimit në distancë në shkollat fillore si dhe ngjajshmëritë dhe dallimet e tyre në vendin tonë. Konceptet kyçe të këtij hulumtimi janë menaxhimi i mësimit në klasë dhe menaxhimi i mësimit në distancë dhe perceptimet e mësime të gjeneratave aktuale, prindërve dhe nxënësve të shkolles fillore lidhur me temën si dhe tregojnë se sa janë të përgaditur shoqëria jonë për tu përballur me këtë problem.

*Kapitulli I* ofron një pasqyrë të përgjithshme lidhur me veçantitë e organizimit dhe menaxhimin e mësimit në klasë dhe mësimit në distancë në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet, qëllimin, rëndësinë, objektivat, hipotezat të cilat i kemi vënë vetes si detyrë për të elaboruar dhe vërtetuar në vazhdim.

*Kapitulli II* ofron një përmbledhje të hollësishme të literaturës, duke përfshirë pasqyra të studimeve dhe kërkimeve mbi konceptet e organizimit dhe menaxhimin e mësimit në klasë dhe mësimit në distancë në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet.

*Në Kapitullin III*, përshkruhet metodologjia e hulumtimit duke përfshirë karakteristikat e mostrës, instrumentet, metodat e mbledhjes së të dhënave, dhe qasja ndaj analizës.

*Kapitulli IV*, paraqet detajet nga gjetjet e studimit.

Në fund, *Kapitulli V* diskuton gjetjet, nxjerrë konkludimet kyçe, shtjellon pikat e forta dhe kufizimet e studimit, udhëzimet e ardhshme për kërkime dhe implikimet për praktikatat e ardhshme.

### ***Qëllimi i hulumtimit***

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të identifikohen ngjajshmëritë dhe dallimet e mësimit në klasë dhe mësimit në distancë. Po ashtu ky hulumtim ka për qëllim të analizoj organizimin dhe menaxhimin e mësimit në klasë dhe mësimit në distancë në shkollat fillore, si dhe të gjejë ngjajshmëritë dhe dallimet me rast studimi shkollat fillore.

### ***Pyetjet e hulumtimit***

Pyetjet e hulumtimit kanë rëndësi thelbësore në një punim shkencor. Ato shprehin qëllimin e hartimit të punimit por dhe drejtojnë procesin e hulumtimit.

Pyetjet hulumtuese në punimin tonë janë:

- Cilat janë specifikat e organizimit të mësimit në klasë dhe të mësimit në distancë?
- Çka ka të përbashkët ndërmjet mësimit në klasë dhe mësimit në distancë?
- Cilat janë dallimet e mësimit në klasë dhe mësimit në distancë?

### ***Hipotezat e hulumtimit***

Duke u bazuar në pyetjet e hulumtimit, janë parashtruar tri hipoteza:

**H1:** Menaxhimi i mësimit në distancë dallon shumë nga veçantitë e menaxhimit të mësimit në klasë.

**H2:** Nuk ka të përbashkëta në mes të mësimit në klasë dhe mësimit në distancë.

**H3:** Dallimet janë të mëdha sidomos te organizimi dhe menaxhimi i orës mësimore.

## II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

### 2 Organizimi i mësimit si vepimtari

Institucioni shkollor jo vetëm në vendin tonë, por në cilindo shtet në mbarë globin konsiderohet padyshim si një tempull i kulturës në një mjedis të caktuar shoqëror.

Shkolla ka për detyrë që t'i japë një hapësirë sjelljes së ndërsjelltë, e cili para se të formohet si faktor kulturor, mund të konkretizohet në praktikën e përditshme, në përvojën e marrëdhënieve ndërmjet mësuesit dhe nxënësit, ndërmjet nxënësve, apo ndërmjet grupeve të ndryshme në orientimin ndaj vlerave dhe veprimit. “Nga pikëpamja pedagogjike, kjo zgjedhje bazë sjell përmbysje në fushën homologe, me të cilën shkolla modelon në interpretimin e fakteve, të personave dhe kulturave, për t'u dhënë konkretisht hapësirë rrugëve të njohjes dhe të përvojës, duke respektuar polaritetin e subjekteve dhe të grupeve” (Walters, J. & Shelly Frey, 2017).

Mësimdhënësi me sjelljen e tij përbën një model referimi për fëmijën. Studimet tregojnë se “Klima relacionale, qëndrueshmëria emocionale, lidhjet socio-afektive dhe mënyrat e komunikimit në klasë nga ana e mësuesit, përbëjnë një faktor të rëndësishëm, të vetëdijshëm, por shumë të kushtëzuar dhe të pasur në planin e formimit të konstrukteve dhe të sjelljeve të fëmijëve” (Charles, M.C, 2015).

Çështja e organizimit dhe menaxhimit të mësimit në klasë dhe mësimit në distancë, edhe pse në dukje mund të mos konsiderohet e një rëndësie të lartë, përbën një çështje kyçe, objektive e delikate të mësimdhënies, brenda kontekstit të të cilës përfshihen shumë aktorë si: mësimdhënësit, drejtuesit e psikologët e shkollave, prindërit e nxënësve dhe mbi të gjitha vetë nxënësit si aktorët kryesorë të të gjithë kësaj skene teatrale të jetës së përditshme (De Beni, M, 2013). Përgjegjësia e organizimit dhe menaxhimit të mësimit dhe e disiplinës në klasë qëndron si tek nxënësi ashtu edhe tek mësuesi, duke i konsideruar të dy faktorë të barazvlefshëm.

Madje mësimdhënësit e suksesshëm në menaxhimin e klasës, qëllimisht kontrollojnë qëndrimet e tyre për të nxitur tek nxënësit sjellje të dëshirueshme. Ata janë të vetëdijshëm se vetë qëndrimi i tyre shërben si një burim i fuqishëm motivues i sjelljeve të përshtatshme të nxënësve.

Nëse nxënësit janë të përgjegjshëm vetëm për sjelljet e tyre në mjedisin e klasës, si dhe ecurinë në mësim, në anën tjetër mësuesve u duhet të menaxhojnë një sërë elementesh për të krijuar një mjedis të përshtatshëm nxënieje por dhe për t'i ndihmuar nxënësit të vetëdisiplinohen (Rothstein, C. & Elies, T, 2015).

Për më tepër inkurajimi i disiplinës pozitive në klasë i nxit nxënësit të arrijnë suksesin e dëshiruar jo vetëm në aspektin e shkollimit por dhe në hapat e mëtejshëm në jetë (Charles, M.C, 2015). Një mjedis i kontrolluar klase do të ishte padyshim një burim suksesi për të nxënësit efikas, do të krijonte marrëdhënie të mira mësues-nxënës por dhe do të inkurajonte bashkëpunimin midis vetë nxënësve gjatë orës së mësimin.

Dallimi në mes të mësimin në klasë dhe mësimin në distancë është shumë i madh për arsye se mësimi në distancë është formë e arsimimit, e cila realizohet përmes teknologjive moderne të komunikimit, me qëllim të mësuarit e nxënësve të vendosur në vende dhe largësi të ndryshme - jashtë ambientit tradicional të mësimin (klasës), (Osmani. S, 2016).

Programet e mësimin në distancë ua mundësojnë mësimdhënësit të ndërveprojnë me njëri-tjetrin nëpërmjet mjeteve kompjuterike, internetit, satelitëve artificialë, telefonave, radiove, televizioneve dhe teknologjive të tjera. Përderisa mësimi në distancë i referohet përvojës së të mësuarit zyrtar ose jozyrtar, edukimi në distancë nënkupton veçanërisht udhëzimin zyrtar (Tafari, V & Valva , L, 2016). Të mësuarit nga distanca mund të llogaritet si komunikim ndërmjet njerëzve në kohë dhe vende të ndryshme. Kjo mënyrë e të nxënësit daton që nga koha e komunikimit ndërmjet njerëzve.



Ata filluan t'i bartin njohuritë e tyre brez pas brezi, madje edhe me fillimin e lëvizjes së tyre nga një vend në vendin tjetër, ku takonin popuj të tjerë me kultura dhe tradita të tjera (Qafa, A, 2014). Pa dyshim se komunikimi i atyre kohërave ishte i vështirë, i ngadalshëm dhe jo i saktë.

Kosova nuk mund të renditet në listën e atyre shteteve që janë duke e implementuar të nxëniet me mësimdhënie nga distanca që mbështetet në e-mësim (e-learning), m-mësim (m-learning), apo të atyre që kanë shkolla virtuale. Prandaj, mund të themi se ky është momenti i duhur për një nismë në fushën e zbatimit të metodologjive të reja (Qafa, A, 2014). Aprovimi i tyre do ta ngrinte shkallën e suksesit të të nxëniet, në përgjithësi, dhe të nxëniet nëpërmjet teknologjive të reja, në veçanti.

Historia e të mësuarit nga distanca është e vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Vështirë është të konstatohet se kur fillon kjo metodë e bartjes së informatave. Ka pasur ndër shekuj sigurisht mënyra e mënyra për bartjen e informatave nga një vend në tjetrin, por këtu do të bazohemi vetëm në atë pjesën e historisë që kemi ndeshur duke hulumtuar në shfletuesit e internetit. Të mësuarit nga distanca është revolucion i arsimit të një vendi (Person, L, 2011). Të mësuarit nga distanca trajtohet si mësim në të ardhmen dhe mëton të jetë vazhdimësi e të mësuarit tradicional, e nuk ka për synim përmbysjen e klasave fizike dhe praninë e mësuesit në klasë. Mëton të jetë ndihmesë për të arritur suksese më të larta në mësimnxënie, sidomos në vendet në zhvillim. Kjo platformë u ofron kushte plotësisht të barabarta të gjithë vijuesve të saj, pavarësisht se ku gjenden ata.

#### ***a. Ndikimi i teknologjisë në organizimin e mësimit***

Termat më të njohur të këtyre kategorive, që luajnë rol të rëndësishëm dhe kanë karakter funksional në organizimin e drejtë të punës mësimore, janë termat: *teknika dhe teknologjia mësimore* (Zylfiu, N, 2002). Këta terma megjithëse të bartur nga lëmenjë e tjerë shkencorë dhe punues në sferën e veprimtarisë mësimore, të njohurit e tyre të drejtë dhe aplikimi i tyre në teorinë dhe praktikën bashkëkohore mësimore, janë çështje tejet me rëndësi në ngritjen dhe efikasitetin e rezultateve përfundimtare të punës mësimore.

Nocionet teknikë dhe teknologji ndryshojnë në mes tyre, siç ndryshon edhe karakteri i aplikimit të tyre në punë mësimore në krahasim me aplikimin e tyre në lëmenjtë e tjerë. Fjala *teknikë*, e cila rrjedh nga gjuha greke (techne), kishte domethënie të shuëfishtë, që përdorej për emërtimet e shkathtësive dhe aftësive për kryerjen e veprimeve të ndryshme (zejtare, artistike, të përdorimit të mjeteve krijuese etj.), (Zylfiu. N, 2002). Kuptimi bashkëkohorë i nocionit teknikë ka një domethënie komplekse, meqë teknika në kushtet bashkëkohore të punës dhe të prodhimit luan rolin ndërmjetësues në mes të teorisë dhe praktikës.

Aftësia organizative e punës mësimore, kultura pedagogjike dhe ajo e përgjithëshme për forma më kreative të përdorimit dhe të zbatimit sa më adekuat të mjeteve mësimore duhet të jetë një nga kërkesat primare që shtrohen para çdo arsimtari.

*Teknika* mësimore sikurse teknologjia mësimore, janë përmbajtje dhe kategori më dinamike mesimore. Me karakterin e tyre të ndryshueshëm, të cilat ndryshime shkaktohen si pasojë e ndikimeve të zbulimeve tekniko-shkencore të lëmënjeve të ndryshëm, bëjnë që mësimi të pasurohet me veti dialektike dhe ergo-dinamike, si proces që nxit aktivitetet e shumëfishta të nxënësve (Zylfiu. N, 2002). Duke u bazuar në këta faktorë, themi se, përpos ndryshimeve permanente të përmbajtjeve arsimore, me inovacione nënkuptojmë edhe aplikimin e mjeteve të ndryshme mësimore si dhe të arrituarat më të reja shkencore dhe ato, teknike dhe teknologjike në mësim, në mënyrë që shkolla jonë të ngritet në nivel më të lartë, duke aplikuar edhe mësimin e programuar, makinat për mësim (nxënie) dhe të arrituarat e inovacionit mësimor ndikojnë pozitivisht në krijimin e situatave të reja ergo-dinamike.

*Teknologjia* mësimore, sikurse që edhe teknika, është nocion i bartur në kuadër të përmbajtjeve terminologjike të teorisë didaktike e cila ka të bëjë kryesisht më gjeturinë sa më racionale dhe produktive të organizimit të punës mësimore në tërësi dhe në pjesët përbërëse të modaliteteve të ndryshme didaktike të mikro-artikulimit mësimor.

Më të përdorurit e teknologjisë bashkëkohore mësimore, pa marrë parasysh se është fjala për teknologji të madhe apo të vogël, puna e arsimtarit në mësim, po ashtu lehtësohet, kurse të kuptuarit e përmbajtjeve mësimore nga ana e nxënësve është në nivel më të lartë, gjë që krejt kjo pasqyrohet në rezultatet përfundimtare të punës mësimore (Zylfiu. N, 2002). Në fund duhet cekur se teknika dhe teknologjia mësimore me përmbajtjet dhe format e realizimit të tyre janë pjesë e rëndësishme e sistemit të zhvilluar të faktorë mësimor. Përmbajtja dhe struktura e tyre, shikuar nga mundësitë e gjëra të aplikimit dhe të organizimit të punës mësimore, më së miri shihen në sistemin e tërësishëm për mjetet mësimore dhe ato ndihmëse-teknike.

#### ***b. Modaliteti - ecuritë e realizimit të tij në procesin e mësimit në klasë***

Organizimi i kohës së mësimit në klasë ndikon në klimën e klasës si dhe në sjelljen e nxënësve. Padyshim mësimdhënia efektive dhe menaxhimi i klasës janë dy terma të pandashëm të cilët plotësojnë njëri tjetrin. Mësues efektivë janë ata që janë të suksesshëm dhe në procesin e menaxhimit të klasës dhe në mënyrë specifike të kohës.

Përse i kushtojmë kaq shumë vëmendje menaxhimit të kohës?

Si ndikon menaxhimi i kohës në ecurinë e mësimit?

Theodhori Karaj në librin e tij “Menaxhimi i klasës” shprehet: “Java e parë e shkollës është tejet e rëndësishme. Suksesi i vitit shkollor përcaktohet nga çfarë bëhet gjatë ditëve të para të shkolles brenda 45 minutave të një ore mësimore. Java e parë ose e dytë e shkollës përcakton atmosferën për pjesën e mbetur të shkollës.” (MASHT, 2020).

Pra ajo që ai nxjerr në pah është pikërisht domosdoshmëria e krijimit të një plani të mirëdetajuar të menaxhimit të klasës, të kohës, të materialeve, etj që në fillimet e vitit shkollor. Në këtë citim, konceptin e kohës ai e sheh në një këndvështrim më të gjerë, dhe jo thjesht 45 minutat e përcaktuara për të realizuar procesin mësimor. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizojmë një proces frytdhënës mësimdhënieje (MASHT, 2020).

Nocioni i orës si një koncept abstrakt i krijuar nga njeriu për të mirëmenaxhuar aktivitetin e jetës njerëzore, duket se është elementi kyç i menaxhimit të çdo dite në shkollë. Në librin “The Key Elements of Classroom Management”, kohës akademike në klasë autori Joyce McLeod i bën një ndarje të tillë:

- ❖ Koha mësimore/e mësimdhënies
- ❖ Koha akademike e të nxënësve
- ❖ Koha e angazhimit

Secila prej tyre do të trajtohet veçmas, dhe në mënyrë më të detajuar në vijim.

Koha mësimore e mësimdhënies - (koha gjatë së cilës mësuesi realizon procesin e shpjegimit) - Në hartimin e planeve ditore, kjo është pikërisht faza kohore kur nxënësi vjen në kontakt me informacionet apo idetë e reja të tekstit mësimor të paraqitura nga mësuesi (Haloqi. A, 2010). Gjatë kësaj kohe ky informacion mund të përçohet nëpërmjet tekstit bazë, duke përdorur teknologjinë e duke parë një video të caktuar, duke dëgjuar një regjistrim, etj në varësi të temës së trajtuar. Padyshim menaxhimi i kësaj kohe është tejet i rëndësishëm, pasi është etapa kryesore e të nxënësve, gjatë të cilës mësuesi ka ndikimin më të madh tek nxënësi në përçimin e informacionit.

Koha akademike e të nxënësve - (koha gjatë të cilës mësuesit mund të provojnë dhe vërtetojnë nëse nxënësit e tyre e kanë përvetësuar përmbajtjen e mësimit apo jo). Në trajtimin e çështjes kohore në kontekstin e mësimdhënies, koha akademike e të nxënësve nënkupton etapën gjatë të cilës ndodh të nxënësve e qëndrueshëm (Haloqi. A, 2010). Pikërisht në këtë fazë nxënësit provojnë përvetësimin e njohurive të reja, nëpërmjet përfshirjes ose jo në pyetjet apo aktivitetet e drejtuara nga mësuesi pas prezantimit të informacionit të ri. Pra ata mundohen të reflektojnë, të shprehin me fjalët e tyre njohuritë e përfutuara prej tyre.

Koha e angazhimit - (koha gjatë të cilës nxënësit janë të angazhuar drejtpërdrejt në veprimtari mësimore brenda mjedisit të klasës). Koha e angazhimit e trajtuar edhe nga Tahir Zajazi në librin e tij *Metodologji të Mësimdhënies dhe Mësimnxënies*, nuk është gjë tjetër vetëm “koha e paramenduar për angazhim të drejtpërdrejtë të nxënësit në veprim konkret.

Gjatë kësaj kohe nxënësi mund të diskutojë, të pyesë, të zgjidhë një ushtrim, të shkruajë një ese, të bëjë një hartim, etj. Të gjitha këto janë teknika apo metoda mësimore që e venë nxënësin në aksion, në veprimtari të drejtpërdrejt.” Pra, nëse koha akademike e të nxënësve shërben për të provuar teorikisht përvetësimin e njohurive të reja, në anën tjetër koha e angazhimit presupozon aspektin praktik të këtij përvetësimi, nëpërmjet ushtrimeve konkrete të realizuara nga nxënësi (Zajazi, T, 2008).

Arti kompleks i mësimdhënies, jo vetëm në gjuhën e huaj por dhe në shkencat e tjera, domosdoshmërisht kërkon një kordinim të arrirë nga ana e mësuesit midis mësimdhënies dhe procesit të menaxhimit të klasës. Objektivat arsimore janë një tregues i qartë i një binomi të dukshëm midis asaj që ne si mësues duhet të arrijmë, dhe asaj që nxënësit duhet të përftojnë. Këto objektiva të shprehura në formën e tyre minimale, mesatare apo maksimale të reflektuara në programet arsimore vjetore dhe planet arsimore ditore nuk na tregojnë mënyrën apo mjetet sesi duhet t’i arrijmë ato (Carol.C, 2010). Ndërkohë që numri i objektivave për t’u arritur nga mësuesit është gjithnjë e më shumë në rritje nën ndikimin e shumë faktorëve, në anën tjetër numri i orëve mësimore në dispozicion të mësuesit është i njëjtë duke e bërë në këtë mënyrë gjithnjë e më të vështirë për t’i realizuar ato në kuadrin e një klase të mirëmenazhuar (Zajazi, T, 2008).

Institucioni shkollor jo vetëm në vendin tonë, por në cilindo shtet në mbarë globin konsiderohet padyshim si një tempull i kulturës në një mjedis të caktuar shoqëror. Ky tempull “pagan”, një term i përdorur për të nënkuptuar faktin që shkolla nuk duhet të jetë e ndikuar nga besimet fetare, ka në përbërjen e tij nxënësit, mësuesit, personelin shërbyes, personelin administrativ pa lënë mënjane prindërit e nxënësve.

Pra të gjithë këta komponentë të kësaj industrie arsimore realizojnë shkollimin e nxënësve (Zajazi, T, 2008). Brenda hapësirës shkollore, pikërisht brenda *hapësirës së qelizës së klasës* realizohen marrëdhënie dhe bashkëveprime njerëzore nxënës-nxënës, mësues-nxënës, prindër-mësues, si dhe prindër-nxënës të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e mësimdhënies. Vlen për t'u nxjerrë në pah se klasa është qeliza bazë, apo njësia bazë e hapësirës shkollore ku realizohet puna bashkëvepruese e nxënësve dhe mësuesit.

Nxënësi është objektivi thelbësor i institucionit shkollor por dhe objektivi kryesor i mjedisit të klasës, prandaj dhe e tërë hapësira shkollore, e tërë strategjia menaxhuese shkollore duhet të orientohet në drejtim të klasës për të rritur efikasitetin e saj në arritjet akademike të nxënësve si dhe në procesin e mësimdhënies.

Karakteristika bazë e një klase të mirëmenaxhuar do të ishte udhëheqja e një procesi mësimi efikas nëpërmjet drejtimit të suksesshëm të nxënësve duke zbatuar autoritet pa përdorur forcën fizike apo psikologjike (Carol.C, 2010). Mjedi i klasës shpesh konsiderohet ndryshe si “laboratori” i një fëmije. Përderisa fëmijët kalojnë një pjesë të mirë të jetës së tyre në shkollë, atëherë është tejet e rëndësishme të mësojmë dhe të orientojmë tërë vëmendjen tonë drejt identifikimit të rolit parësor të *menaxhimit të klasës dhe menaxhimit të disiplinës* si një dinamikë thelbësore në përvojën dhe suksesin e nxënësve jo vetëm në mjedisin e shkollës por dhe në mjedisin rrethues shoqëror.

Një mjedi i kontrolluar klase do të ishte padyshim një burim suksesi për të nxënësit efikas, do të krijonte marrëdhënie të mira mësues-nxënës por dhe do të inkurajonte bashkëpunimin midis vetë nxënësve gjatë orës së mësimi (Walters, J. & Shelly Frey, 2017).

Shumë mësues janë të mendimit se afërsisht ½ e orës së mësimi përbëhet nga aktivitete të lidhura me procesin e menaxhimit për të vendosur rregullin në klasë, për të dhënë udhëzime sa më të qarta, etj., më tepër sesa mësimdhënie.

Por duke marrë në konsideratë objektivat arsimore të vendosura nga Ministria e Arsimit, (MASHT, 2020), jo vetëm e vendit tonë por dhe e vendeve të tjera, si dhe përgjegjësia në rritje e përmbushjes së këtyre objektiveve për të siguruar suksesin e shkollës, të mësuesve dhe mbi të gjitha të nxënësve, rezulton se *menaxhimi i klasës* përbën një element kyç në këtë drejtim.

Koordinimi dhe aplikimi i teknikave të përshtatshme menaxhuese nga ana e mësuesit do të sillte një përfshirje e aktivizim më të madh të nxënësve gjatë procesit mësimor, gjë që do të përkthehej në zbatimin e shumë me tepër aktiviteteve mësimdhënieje dhe nxënieje gjatë 45 minutave të orës së mësimit (Mc Queen, Th, 2012).

Në qoftë se menaxhimi i klasës përfshin drejtimin dhe orkestrimin e të gjithë elementëve të nevojshëm për të krijuar dhe garantuar kushtet optimale për mësimdhënie dhe të nxënë të suksesshëm, në anën tjetër vetë menaxhimi si koncept përfshin disiplinën, e cila në kuadrin e menaxhimit i referohet qëndrimit që mban mësuesi në klasë për të inkurajuar vetëkontrollin e nxënësve, për t'i mbajtur ata të motivuar e për të shmangur pasoja të pakëndshme sjelljeje gjatë një ore mësimi (Mc Queen, Th, 2012).

Unë mendoj se menaxhimi i klasës fillon me ndërtimin e besimit dhe marrëdhënieve të mira në mes të mësimdhënësit dhe nxënësit, pa prezencën e të cilave është e vështirë të zhvillohet mësim normal në klasë. Këto marrëdhënie fillojnë të ndërtohen që nga dita e parë e mësimit duke kaluar nëpër disa faza derisa nxënësit të ndjehen të lirë dhe të shprehin gatishmërinë e tyre për mësim. Mësuesi duhet t'i stimulojë fëmijët të marrin pjesë aktive në planifikimin, rregullimin dhe mbajtjen e klasës.

### ***1. Çfarë kuptojmë me menaxhimin e mësimin në mjedisin e klasës?***

Padyshim klasa është një mjedis i brendshëm parësor brenda institucionit shkollor në të cilin nxënësit kalojnë pjesën më të madhe të kohës bashkë me moshatarët e tyre (Carol.C, 2010).

Menaxhimi i klasës apo organizimi i klasës janë dy terma në thelb të të cilave qëndron qëllimi i krijimit të një mjedisi mikpritës, me kushte optimale për nxënësit në të cilin realizohet të nxëniti efikas, produktiv, përfshirës dhe mbështetës.

Trajtimi teorik mbi menaxhimin e klasës, dhe reflektimi rreth metodologjisë efektive për zbatimin praktik në klasë, janë dispozitat themelore me të cilat mund të realizohet mësimdhënia e suksesshme. Është e vërtetë se mësimdhënësi përballet çdo ditë me befasi, të cilat i vijnë papritur, ani pse ai nuk ka parashikuar raste të tilla, por se si mund t'iu shmanget ai këtyre problemeve të cilat e pengojnë zhvillimin normal të procesit mësimor, kjo varet se sa ai posedon aftësi dhe njohuri menaxhuese të klasës, si arrin ta koordinojë dhe stabilizojë objektin si tërësi e zhvillimit të mësimi (Haloqi. A, 2010). Menaxhimi i mësimi ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të tilla të të nxëniti duke synuar që të maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësit në mësim.

Mësimin në mjedisin e klases e menaxhon mësimdhënësi, në ato klasa ku ka numër të madh të nxënësve ndodhë që mësimdhënësi të hasë në destabilizimin e nxënësve, si rezultat i kësaj ngarkese të madhe p.sh. kur mësimdhënësi është duke e korrigjuar punën e një nxënësi, duke ndihmuar atë (Murati, Xh, 2012), apo duke i dhënë ndonjë sugjerim ndaj temës mësimore, pjesa tjetër e nxënësve mund të eskalojë nga stabiliteti paraprak, si p.sh. fillojnë bisedën, pëshpërisin, ngacmohen, qeshin, të tjerët mund të tërhiqen drejt vështrimeve ndaj dritareve jashtë tyre, etj., ku e tërë kjo katandisje mund të vijë si rezultat i menaxhimit të dobët nga ana e mësimdhënësit.

Që nga fillimi i çdo viti shkollor, mësimdhënësi paraqet planin dhe programin mësimor dhe kriteret apo kërkesat, të cilat u drejtohen nxënësve, dhe ato duhet t'iu thotë me bindshmëri, ndikim dhe qëndrueshmëri tek nxënësit, që më pas ato të gjejnë aplikimin e tyre në praktikë. Natyrisht se kjo rregullativë e mësimdhënësit bëhet për qëllime pozitive dhe (Haloqi. A, 2010), në këtë kontekst, ai krijon një lloj marrëveshje me nxënësit, ku këta të fundit mund të japin propozimet e tyre, por pa dalë jashtë normave me të cilat drejtohet klasa dhe mësimi si tërësi.



Nëse këto parashtrime të cilat bëhen nga ana e mësimit, me kalimin e kohës pësojnë lëkundje, atëherë kjo reflektohet negativisht nga ana e nxënësve, të cilët mund ta keqpërdorin dhe t'ia etiketojnë mësimit, çka ndikon negativisht tek ai, i cili tashmë ka humbur besimin e nxënësve, duke u futur në një valle pa e ditur ritmin e lojës së saj (Haliti, Sh, 2007). Në këtë aspekt, nga mosserioziteti, parimësia, konsistenca dhe racionalizmi, nxënësit jo vetëm që do ta urrejnë mësimit, por edhe lëndën mësimore të cilë ai ligjëron. Megjithatë, për t'iu shmangur devijimeve të tilla, atëherë duhet t'ia referohemi rekomandimit konstruktiv të cilin na e këshillon metodologjia e suksesshme e mësimit, saktësisht metodat e menaxhimit të klasës.

Pavarësisht se cilat forma të punës mësimore mësimit ka vendosur t'ia aplikojë gjatë orës mësimore, ai mund të bëjë edhe kombinimin e tyre me qëllim që të nxis aktivitetin e përgjithshëm tek nxënësit. Dy aspekte më të rëndësishme që kanë të bëjnë me fillimin e mësimit janë përpikmëria dhe rregullimi mendor (Musai, B, 2017). Është shumë e rëndësishme dhe mjaft efektive për nxënësit, nëse mësimit arrin me kohë ta fillojë procesin mësimorë, madje përpikmëria, në këtë drejtim, do t'ia dërgonte mesazhe nxënësve se sa është i nevojshëm, i drejtë dhe racional, respektimi i kohës dhe orarit të mësimit.

Zakonisht minutat e parë janë periudhë e parapërgatitjes, ngase në njërin anë mësimit shënon orën mësimore, ndërsa në anën tjetër, nxënësit përgatisin materialin që u nevojitet gjatë asaj ore. Pas përfundimit të kësaj procedure, mësimit duhet të ngrihet dhe të vendos materialin që i nevojitet për njësinë e caktuar mësimore (Haloqi. A, 2010). Atë e vendos para nxënësve dhe kështu me një shikim gjithpërfshirës “në formë kamereje”, duhet t'ia jap sinjalin nxënësve se tani jemi gati për të filluar.

Natyrisht që mësimit fillon sipas planit ditor të cilin e ka mësimit, dhe çdoherë për të paraqitur qëllimin e orës ai u bën pyetje nxënësve, të cilat e ndërlidhin njësinë e kaluar me atë të tashmen. Pra, këto janë aspekte të cilat e sigurojnë mësimit se mobilizimi mendor, nga ana e nxënësve, tashmë është siguruar (Musai, B, 2017). Preferohet t'ia themi nxënësve në formë pyetjeje, jemi gati për të filluar?, kjo në njëfarë mënyre do të siguronte përgjigjen e duhur.

Atributi themelor i mësimdhënësit është edhe përfundimi i mësimit, koha e caktuar, shfrytëzimi i arsyeshëm dhe me mend i saj. Atëherë kur përfundon ora mësimore, përkatësisht kur bie zilja, tek nxënësit nuk ka mësim më, nuk ka interes dhe vazhdimi i mësimit pas kësaj kohe do të ishte joracional për mësimdhënësin dhe i padrejtë për nxënësit (Haliti, Sh, 2007). Mirëpo, ai (mësimdhënësi) duhet të programojë gjithë veprimtarinë kohore dhe të krijojë kështu hapësirë për zbatimin e të gjitha parashikimeve të tij. Ai nuk guxon as të përfundojë orën mësimore para se të vijë sinjali i ziles, por edhe nuk guxon ta vazhdojë atë pas përfundimit të saj.

Shtrohet pyetja, çfarë të bëhet nëse njësia mësimore ka përfunduar pak minuta para se të bie sinjali i ziljes? Është e nevojshme të bëhet një përsëritje, përmbledhje ose rezyme e njësisë së zhvilluar, duke i aktivizuar kështu të gjithë nxënësit. Kur të përfundojë ora mësimore duhet të merren të gjitha mjetet mësimore me vete dhe të përshëndeten nxënësit me “Mirupafshim!”, “Ditën e mirë”, “Suksese”, etj., (Haloqi. A, 2010). Këto ishin aspektet dhe parimet që hyjnë në kontekstin e fillimit dhe mbarimit të orës mësimore, veti të cilat duhet t’i planifikojë, organizojë dhe realizojë mësimdhënësi në përputhje me hapësirën kohore.

Tipare të tjera dalluese të cilat vërehen nga këndvështrimi menaxhues, janë edhe ato të krijimit të klimës së klasës, e që janë kompetencë e plotë e mësimdhënësit. Ai gjithnjë duhet të tregojë vullnet, gatishmëri dhe konsistencë fizike për të kontrolluar dhe organizuar subjektet në tërësi. Do të ishte konstruktive nëse mësimdhënësi shfaq gëzim, interesim, sinqeritet dhe kënaqësi para dhe gjatë organizimit të orës mësimore.

Vetitë të cilat janë të pëlqyera dhe të pranueshme nga nxënësit, e që lënë përshtypje pozitive për drejtuesin (mësimdhënësin) e tyre, janë:

- ✚ Të jenë më të sigurt, më të përzemërt dhe më të shoqërueshëm;
- ✚ Të jenë më nxitës;
- ✚ Të përdorin më shumë kontaktin me sy;
- ✚ Të përdorin më shumë humorin;

- ✚ Të jenë më të qartë rreth rregullave të klasës së tyre;
- ✚ Të vendosin më mirë praninë dhe autoritetin e tyre;
- ✚ Të komunikojë hapur dhe shpesh duke përdorur më shumë dialogun se monologun (Musai, B, 2017).

Gjithashtu mund të themi se menaxhimi efikas, krahas përkufizimeve të dhëna më sipër kërkon marrjen në konsideratë të aspektit kulturor, si një element kryesor në zhvillimin e marrëdhënieve të kujdesshme në bashkëveprimin jo vetëm midis nxënësve, apo mësuesve e nxënësve por dhe me familjet e tyre.

## **2. Përkufizime rreth termit të menaxhimit të mësimit në klasë**

Përkufizime të ndryshme i hasim rreth menaxhimit të klasës, disa prej të cilave do të citohen më poshtë:

- “Menaxhimi i klasës përfshin strategjitë e ndryshme që mësuesit përdorin për të siguruar një mjedis produktiv, harmonik të të nxënësve që parandalon shqetësimet gjatë procesit të të nxënësve.” (Rothstein, C. & Elies, T, 2015).
- “Menaxhimi i klasës i referohet shumëllojshmërisë së teknikave dhe aftësive që mësuesit përdorin për t’i mbajtur nxënësve të organizuar, të përqëndruar, të angazhuar në detyrat e tyre për të qenë akademikisht produktivë gjatë një ore mësimi.” (Tafari, V & Valva , L, 2016).
- “Menaxhimi i klasës përkufizohet si një bashkësi procedurash të zbatuara nga mësuesit për nxënësve në mjedisin e klasës, me qëllimin e vetëm të të inkurajuarit të një sjelljeje prosociale dhe për të parandaluar apo shmangur sjelljet e papranueshme. Këto procedura konsiderohen si universale përderisa ato zbatohen me të tërë klasën dhe jo me individë të veçantë që kërkojnë mbështetje specifike” (The Campbell Collaboration, 2011).

- “Menaxhimi i klasës përfshin veprimet e ndërmarra nga mësuesi për të krijuar një mjedis që mbështet dhe lehtëson të nxënit e njohurive të reja, të nxënët emocional e social.” (Walters, J. & Shelly Frey, 2017).
- “Menaxhimi i klasës është mbajtja apo ruajtja e një mjedisi të shëndetshëm në klasë, relativisht të lirë nga problemet e sjelljes.” (Zekaj, Xhevdet & Kozma Grillo, 2013).
- “Menaxhimi i klasës përfshin një sistem të tërë elementësh siç janë krijimi i marrëdhënieve shoqërore, organizimi i kohës dhe hapësirës, si dhe marrja në konsideratë e diversitetit të larmishëm të nxënësve, ekonomik, social apo arsimor.” (Scarlett, W, 2015).
- “Menaxhimi i klasës është aftësia e mësuesit për të menaxhuar kohën, hapësirën, materialet e burimet e ndryshme, sjelljet e nxënësve, duke krijuar kështu një klimë inkurajuese për nxënësin.” (Wright, T, 2015).

Bashkëpunimi i vërtetë në mes të mësimit dhe nxënësit duhet të jetë i ndërvarur, që do të thotë se të gjithë nxënësit duhet të ndajnë përgjegjësinë dhe të marrin vendime në të gjithë procesin e tyre të të mësuarit. Ata sigurisht do të kenë nevojë për udhëheqje, sidomos në fazat e hershme të projektit-planifikimit.

Nga sa mund të vërehet, në tërësinë e përkufizimeve të tilla mbi menaxhimin e klasës, vlen të theksohet se procesi i menaxhimit është një proces tepër kompleks i një mjedisi të brendshëm shkollor që përfshin shumë elementë të ndërlidhur me njëri tjetrin duke filluar që nga menaxhimi i kohës dhe hapësirës, menaxhimi i aktiviteteve, teknikave të shumëllojshme, ulja e nxënësve në banga, sistemimi i materialeve të punës që të mund të sigurojnë një përfshirje multiaktive të nxënësve, marrja në konsideratë e faktorëve të ndryshëm jashtë shkollorë, diversiteti në klasë, etj., (Walters, J. & Shelly Frey, 2017).

Bazuar në elementët e mësipërm që karakterizojnë procesin e udhëheqjes dhe menaxhimit, brenda kontekstit të mjedisit të klasës studimi fokusohet në nocionet e mëposhtme kryesore të menaxhimit të cilat janë:

- Koha mësimore
- Hapësira fizike
- Pjesëmarrja dhe aktivizimi i nxënësve (Wright, T, 2015).

Roli shumë i rëndësishëm në menaxhimin e klasës është ai i udhëheqësit. Udhëheqësi është personi autoritar dhe të udhëhequrit është një cilësi që mësohet. Kështu, si mësues, duhet të jepni modelin si e hap diskutimin një udhëheqës, si aktivizon pjesëmarrësit, sqaron thëniet dhe kërkon mendimin e të gjithëve (Musai, B, 2013). Udhëheqësve duhet t'u mësohet si të palnifikojnë diskutimet, të organizojnë grupet për rezultate maksimale, të drejtojnë diskutimin dhe të bashkërendojnë dhënien e detyrave të ndryshme individuale.

Qëllimi i udhëheqësjes dhe menaxhimit është realizimi i një mësimdhënieje efikase nëpërmjet përdorimit të teknikave praktike madje dhe ato transformuese që çojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës, në uljen e sjelljeve të padëshiruara dhe rritjen e motivimit, si dhe në krijimin e një komuniteti mikpritës në klasë që synon nxitjen e një filozofie suksesi jo vetëm me nxënësit individualisht por me të tërë klasën si një njësi e vetme (Walters, J. & Shelly Frey, 2017).

### **3. Menaxhimi dhe disiplina e mëimit në klasë**

Përpara se të vazhdojmë më tej në trajtimin e çështjes së menaxhimit të klasës është tepër e rëndësishme të nxjerrim në pah ndryshimin/dallimin midis dy termave: *menaxhimi i klasës* dhe *disiplina e klasës* (Walters, J. & Shelly Frey, 2017). Pavarësisht se shumë shpesh përdoren lehtësisht të shkëmbyeshme, ato përbëjnë dy çështje të ndryshme tejet të rëndësishme të cilat zhvillohen paralelisht me njëra tjetrën.

**Së pari**, nëse menaxhimi i klasës i referohet konkretisht mënyrës së zbatimit të strategjive e teknikave të ndryshme gjatë orës së mëimit, menaxhimit të aktiviteteve të larmishme, menaxhimit të punës me grupe, lojës me role, mënyrës së vendosjes së nxënësve në klasë, menaxhimit të kohës, etj. në anën tjetër menaxhimi i disiplinës përbën menaxhimin specifik të sjelljes së nxënësve.

Menaxhimi i klasës përfshin strukturën e mësimdhënies, procedurat e realizimit të mëimit; ndërkohë disiplina fokusohet tek menaxhimi i sjelljeve impulsive apo vetë-kontrolli i nxënësve (Walters, J. & Shelly Frey, 2017).

*Së dyti*, nëse menaxhimi i klasës si proces është përgjegjësi kryesisht e mësuesit, disiplina në anën tjetër është përgjegjësi e përbashkët e nxënësve e mësuesve dhe e qëndrimeve të tyre brenda këtij mjedisi nxënës. Arsyeja përse këto terma shpesh përdoren si shprehje pazgjidhshmërisht të lidhura e sinonimike të njëra tjetrës është se mësuesi fillimisht përpiqet të krijojë mjedisin e përshtatshëm në klasë për të vështuar sesi do të reagojnë nxënësit e tij, pra të vendosë disiplinën e më pas të angazhohet me menaxhimin e orës së mëimit (Walters, J. & Shelly Frey, 2017). Por mund të jetë dhe e kundërta, mirëmenaxhimi i orës së mëimit nga mësuesi natyrshëm vendos disiplinën e dëshiruar prej tij.

Një ndër shqetësimet kryesore që mësuesit në mënyrë të vazhdueshme përjetojnë në profesionin e tyre janë pikërisht pyetjet:

- A do të arrijë të realizojë mësimdhënie kompetente?
- A do të mundem të ushtrojë kontroll drejtues në menaxhimin e orës mësimore?
- A do të jem i gatshëm të përballoj me sukses çdo pasojë të sjelljes së keqe të nxënësit (Musai, B, 2017).

Menaxhimi i klasës përfshin menaxhimin e nxënësve, të hapësirës, kohës, materialeve e burimeve të ndryshme nga mësuesi për t'i mundësuar nxënësve të mësojnë përmbajtjen e synuar në kurrikulat e paracaktuara të lëndëve të ndryshme. Megjithatë sërish mbetet një sfidë e përhershme, madje dhe për mësuesit “veteranë” pavarësisht viteve të tyre të përvojës, gjetja dhe zbatimi i praktikave të reja menaxhuese për kontigjentet e rinj të nxënësve që sjellin gjeneratat pasardhëse, gjenerata që sa vjen e më shumë paraqiten si problematike në çështjet etike të sjelljeve të pranueshme (Wright, T, 2015).

Të japësh mësim në një klasë me 30-40 apo më shumë nxënës, kërkon mjeshtëri menaxhuese dhe organizuese. Menaxhimi i suksesshëm i mësimit kërkon prej mësuesit të jetë, vazhdimisht, i vëmendshëm dhe në veprim, për t'u siguruar se nxënësit mësojnë normalisht (Osmani Nexhmie, 2015). Problemi kryesor me të cilin ndeshen mësuesit është të mbajnë të përfshirë nxënësit gjatë gjithë mësimit, për të realizuar në mënyrë të suksesshme objektivat e parashikuara.

Në çdo kohë mësuesi ka kërkesa të ndryshme e bashkëveprime të shumta, që e shtyjnë përpara veprimin. Situatat mund të shfaqen nga më të ndryshmet. Për shembull, mësuesi është duke i dhënë një detyrë një nxënësi, por, në të njejtën kohë, një nxënës tjetër kërkon një mjet ndihmës, gjithashtu vë re se një nxënës i tretë është duke vështruar nga dritarja dhe në të njejtën kohë i tërheqjen vëmendjen një nxënës tjetër që kërkon t'i kontrollojë detyren (Haliti, Sh, 2007). Menaxhimi i mësimit ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të tilla të të nxënës duke synuar që të maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësit në mësim. Për shumicën e mësimdhënësve, përballja me disk nga problemet e sjelljes është e përditshme.

Këto probleme mund të përfshijnë shkelje të lehtë të rregullave të shkollës, por edhe mund të përmbajnë ngjarje më serioze, përfshirë mungesën e respektit, sharje madje edhe shenja të shfaqjes së urrejtjes dhe armiqësisë midis nxënësve (Musai, B, 2017). Është e rëndësishme të theksojmë se menaxhimi i klasës fillon me zhvillimin e ndërtimit të besimit dhe marrdhënieve midis nxënësve. Pa ndjenjat e respektit dhe besimit të ndërsjelltë mësimdhënësi e ka të vështirë, në mos të pamaundur, të kryejë rolin e tij në klasë.

### ***c. Mësimi në distancë, baza filozofike e pedagogjike***

Pa dyshim, me përdorimin e internetit, të mësuarit në distancë u bë një përditshmëri e lehtë dhe e shpejtë, përderisa lundrimi nëpër internet për të gjetur se ku janë fillet e të mësuarit nga distanca na ndihmon ta kemi një pasqyrë më të afërt për kohërat e mundimshme për të nxënë nga distanca.

Të mësuarit nga distanca e ka një histori të largët. Si nismëtar të të mësuarit nga distanca gjejmë fundvitet e 1800-tës, e themeloi pranë kolegjit të tij në Angli, kurse me korrespondencë të cilat do të ndiqeshin nëpërmjet postës ndërmjet studentëve në Gjermani, Kanada, Austri, Bashkimin Sovjetik, Japoni, Shtete e Bashkuara etj., (Walters, J. & Shelly Frey, 2017).

William Rainey Harpe, si president i parë i Universitetit të Çikagos, parashikoi që disa studentë të këtij universiteti që janë larg dhe nga zonat rurale mund ta ndjekin me korrespondencë pjesë të studimeve (Gaebel, Michael, 2014). Ky numër i studentëve rritet dukshëm pas Luftës së Dytë Botërore, kur shumë ushtarë, që e kishin ndërprerë shkollimin për shkak të luftës, do t'i ndiqnin pjesët e mbetura të shkollimit të tyre nga distanca pa shkëputje nga puna.

Në të mësuarit nga distanca nga viti 1850-1960, që konsiderohet si gjenerata e parë që ndoqi të mësuarit nga distanca, komunikimi kryesisht bëhej nëpërmjet teknologjive, si posta, shtypi, radio dhe televizioni.

Gjenerata e dytë e të mësuarit nga distanca i përket periudhës së viteve 1960-1985 dhe përfshin përdorimin e audio-kasetave, televizorëve, videokasetave, faksit dhe shtypit.

Walden University, (2016) e themelon Open University në vitin 1970, i cili akreditohet për studime të plota në distancë në shëndetësi, arsim, menaxhim, psikologji etj., (Mc Queen, Th, 2012). Ky universitet në Shtetet e Bashkuara njihet si lider global i studimeve nga distanca, i cili e vazhdon punën e tij edhe sot me studime në distancë në shumë fusha studimi.

Gjenerata e tretë e mësimit në distancë, e cila përfshin periudhën nga vitet 1985-1995, përdori teknologjitë e kompjuterëve dhe rrjeteve kompjuterike. Aktualisht jemi në gjeneratën e katërt të të mësuarit nga distanca, që fillon nga viti 1995, kur përdoren kombinime të ndryshme të pajisjeve dhe sistemeve të kaluara të të mësuarit nga distanca, ndikuar nga zhvillimi i hovshëm i teknologjive të reja të informatikës dhe kompjuteristikës (MASHT, 2020).



Tani studimet në distancë zhvillohen në kohë reale nëpërmjet e-mësimit dhe m-mësimit (e learning & m-learning), nëpërmjet videokonferencave, korrespondencës së dyanshme në kohë reale në mënyrë audio-vizuale. Korrespondenca mbahet në relacionet: student-mësimdhënës, student-student etj. Prandaj, siç mund të gjejmë edhe më gjerësisht nëpër historinë e zhvillimi të të nxënit nga distanca, konkludojmë se ky lloj i të mësuarit është mjaft kompleks. Zhvillimi i tij është i mundimshëm dhe zgjat shumë.

Për shkak të faktorit më të rëndësishëm të të mësuarit, motivimit, shpesh ka ndodhur që pjesëmarrësit e këtyre studimeve ta humbin durimin, dhe si rrjedhojë ka qenë braktisja e shkollave të tilla (Nikoleta, M, 2013). Por, ka edhe të tillë që megjithatë e kanë ruajtur motivin duke shkuar deri në fund, për çka edhe janë shpërblyer me vende pune, ngritje pagash, ruajtje apo ndërrim të vendeve të punës, kalim në grada më të larta etj. Kjo mënyrë e studimit sot konsiderohet edhe si mësim gjatë gjithë jetës, për të cilin këshillohen të gjithë, pa dallim.

### ***1. Modalitet e organizimit të mësimit në distancë***

Me fillimin e botimit të teksteve për mësimin e programuar e më vonë me përdorimin e kompjuterëve dhe internetit, filloi edhe mundësia për të praktikuar mësimin në distancë. Tani duke iu falenderuar teknologjisë dhe avancimit të saj kemi arritur që shumë shpejt të kemi edhe platformat të ndryshme të cilat na mundësojnë të organizojmë dhe të menaxhojmë mësimin në distancë (Techradar, 2021). Hapja e shumë shkollave dhe kolegjeve publike dhe private si në vendin tonë ashtu edhe jashtë tij ka bërë të mundur trajnimin e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë dhe platformave të ndryshme të cilat mundësojnë organizimin dhe menaxhimin e mësimit nga distanca.

Në botën e edukimit në internet, i njohur si mësimi në distancë, klasa mund të jetë asinkron ose sinkron. Mësimi i sinkronizuar në distancë ndodh kur mësimdhënësi dhe nxënësit bashkëveprojnë në vende të ndryshme por në të njëjtën kohë (Littlefield. J, 2021).

Nxënësit e regjistruar në kurse sinkronike zakonisht duhet të hyjnë në kompjuterin e tyre gjatë një kohe të caktuar të paktën një herë në javë. Mësimi sinkron në përgjithësi ofron mundësi më të mirë për nxënësit të cilët mund të planifikojnë ditë dhe kohë të caktuara për mësimet e tyre (Littlefield. J, 2021). Njerëzit që duan kurse të strukturuar të rënda në ndërveprimin e nxënësve shpesh preferojnë të mësuarit sinkron.

Mësimi asinkron në distancë ndodh kur mësimdhënësi dhe nxënësit bashkëveprojnë në vende të ndryshme dhe në kohë të ndryshme (Littlefield. J, 2021). Nxënësit e regjistruar në kurse asinkrone janë në gjendje të përfundojnë punën e tyre sa herë që ju pëlqejnë. Nxënësit me orare të ndërlikuara shpesh preferojnë të mësuarit asinkron të distancës (Littlefield. J, 2021). Ajo gjithashtu tenton të ofrojë mundësi më të mirë për nxënësit e vetë-motivuar që nuk kanë nevojë për udhëzime direkte për të përfunduar detyrat e tyre.

### ***Mësimi i programuar***

Qëllimi i të mësuarit të programuar është që të organizojë mësimin e njeriut në kushte të kontrollueshme. Tipike në këtë lloj të mësuari është se, teksti mësimor paraqitet në një seri njësisht shumë të vogla të quajtura struktura (Platform-e-learning, 2020).

Organizimi bashkëkohor i procesit mësimor, falë të ariturave shkencore, veçanërisht të kibernetikës dhe teorisë së informimeve, shtron nevojën dhe domosdoshmërinë e zbatimit të mësimin të programuar.

Mësimi i programuar paraqet një ndër sistemet bashkëkohore mësimore, i cili ka për qëllim “që puna mësimore të intensifikohet mirë, racionalizohet dhe individualizohet” (Vojka-Ismajli, H, 2012). Mësimi i programuar është formë e tillë e mësimin ku përmbajtja mësimore mbarështrrohet në mënyrë të veçantë. Ajo u paraqitet nxënësve në pjesë të vogla paraprakisht të përgatitura të cilat ato i përvetësojnë në mënyrë të pavarur, duke kontrolluar shkallën e përvetësimit të këtyre përmbajtjeve nëpërmjet informatës së përhershme rekrute (kthyes).

Gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve, nxënësve u jepet mundësi që vazhdimisht duke analizuar dhe sintetizuar njohuritë e reja, të nxisin dhe të zhvillojnë të menduarit kritik.

Vetë nocioni “programim nënkupton “përpunimin e saktë të asaj që programohet, mandej mundësitë e shkallës së verifikimit objektiv në të cilën detyra e programuar zgjidhet” (Vojka-Ismajli, H, 2012). Kështu mësimi i programuar duhet t’i bart nga mësimi tradicional të gjitha elementet pozitive të etapave të mëparshme të mësimit.

Veçoritë themelore të mësimit të programuar janë (Vojka-Ismajli, H, 2012):

1. Nxënësi e përvetëson mësimin nëpërmjet mësimit të pavarur të ashtuquajtura “leksione”, dhe tema të cilat përmbajtja mësimore është e programuar në mënyrë të saktë dhe të strukturuar në mënyrë logjike,
2. Gjatë procesit të përvetësimit të përmbajtjeve mësimore, nxënësit përparojnë hap pas hapi sipas ritmit të tij dhe pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të mësimitdhënësit,
3. Përmbajtjet mësimore të përvetësuar kontrollohen në mënyrë sistematike në mbështetje të informatave kthyesë, ku çdo nxënës kalon në hapin vijues atëherë kur janë përvetësuar etapat e mëparshme,
4. Vlerësimi i tërë programit mësimor,
5. Zbatimi i njohurive të përvetësuar në situata të reja të nxënies dhe të praktikës.

Procesi i zhvillimit të punës mësimore në mësimin e programuar i cili realizohet përmes materialeve të programuara ose të makinave të programuara për nxënie, mbështetet kryesisht në teorinë bashkëkohore të kibernetikës dhe të informimit rekurent të sistemit të komunikimit feedback (Vojka-Ismajli, H, 2012). Në terminologjinë e mësimit të programuar, programi është përmbajtja e materialit të programuar, materiali i programuar është forma e jashtme e përmbajtjes së programuar, sekuenca e programuar paraqet tërësinë më të ngushtë të përmbajtjes së programuar, e cila është planifikuar për t’u mësuar brenda një ore gjatë disa orëve, ndërsa artikulli është njësia më e vogël logjike brenda programit të sajuar.

Elementet përbërëse të artikullit janë: informata për nxënësin, detyrat të cilat nxënësi duhet t'i realizojë, hapësira për zgjidhjen e detyrës dhe informata kthyesë ose rekurrençe. Ecuria metodologjike e punës në sajimin e materialit të programuar është:

- Zgjedhja e përmbajtjes e cila do të programohet
- Përcaktimi operativ i detyrave të programuara
- Përpilimi i instrumenteve për kontrollimin e njohurive
- Verifikimi i paranjohurive dhe i aftësive të tjera të nxënësit
- Analiza e hollësishme e përmbajtjes mësimore që programohet
- Organizimi dhe sistematizimi i përmbajtjes
- Përpilimi i artikujve dhe renditja e tyre në sekuenca të programuara
- Kontrollimi i materialit të programuar
- Zbatimi provues (sondazh) dhe korigjimi i nevojshëm
- Përpilimi i udhëzimeve për zbatim të materialit të programuar (Vojka-Ismajli, H, 2012).

Mësimdhënësi në kushtet e organizimit të këtij sistemi mësimor është organizues, planifikues, drejtues, hulumtues dhe verifikues i procesit mësimor. Me anën e materialeve të programuara ai i përshtatet logjikës së të nxënësit, ka mundësi të reja për nxënie, nxit aktivitetin e nxënësve, bën mësimin më atraktiv, më ekonomik dhe më efikas. Mësimi i programuar, që realizohet me ndihmën e makinave për nxënie, të cilat janë ndërtuar si shprehje e nevojave bashkëkohore të mësimin, sot kanë arritur shkallë të lartë të përsosjes teknike dhe elektronike (Vojka-Ismajli, H, 2012). Makinat elektronike kanë konstruktiv më të ndërlikuar dhe janë më funksionale se ato mekanike. Ato shfrytëzohen për grumbullimin, dhënien e informatave mësimore dhe kontrollimin e rezultateve të të nxënësit.

Mësimi i programuar ka edhe të metat e tij. Para së gjithash, mësimi i programuar nuk është njësoj efikas në të gjitha lëndët mësimore dhe u përgjigjet më shumë nxënësve me aftësi modeste. Fakti që mësimi i programuar është i udhëzuar, kufizon pavarësinë e nxënësit në kërkimin dhe në zbulimin e përgjigjeve dhe të të zgjedhjeve më të mira.

Mësimi i programuar duke u mbështetur në hapat e vegjël logjikë mendohet se “nuk zhvillon sa duhet aktivitetet mendore, siç janë analiza dhe sinteza, abstraksioni dhe përgjithësimi, që karakterizon të menduarit e pavarur dhe abstrakt dhe veprimtarinë produktive intelektuale” (Vojka-Ismajli, H, 2012).

### ***E-mësimi***

E-Mësimi përfshinë të gjitha format e të mësuarit të mbështetura nga teknologjia elektronike. Me të mësuarit elektronik, me ndihmën e kompjuterit mund të gjejmë materiale të ndryshme ku nxënësit do kenë mundësi t’i shohin gjërat, të cilat i mësojnë, kanë mundësi t’i krahasojnë dhe analizojnë (Techradar, 2021). Përparësitë e e-Mësimit janë, përveç që mund të shihen fotografitë, mund të përdoren edhe video e materialet të ndryshme me multimedial, bëhet mbajtja e mësimit në distancë, mbajtja e testeve “online”, përgatitja e mësimit nga mësimdhënësi gjithashtu edhe nga studenti kur i ipet si detyrë shtëpie.

Mësimi fizik ka mangësi, ku flitet gjithë orën, por nxënësi t’i kuptojë pasi nuk sheh diçka konkrete edhe ato çka i ka dëgjuar shumë shpejt i harron, ndërsa e-mësimi i ka këto përparësi (Techradar, 2021). Të mësuarit sinkronik në distancë mund të përfshijë komponentë multimedialë, si bisedat grupore, seminarët e uebit, konferencat video dhe thirrjet telefonike. Sa i përket mësimi asinkron në distancë shpesh mbështetet në teknologji të tilla si email, e-mësimi, forume në internet, regjistrime audio dhe video incizime.

Veglat e e-Mësimit janë: klasa me kompjuter, projektori, laptopi i mësimdhënësit, rrjeti i instaluar, skaneri, printer.

E-Mësimi është një departament edukimi që funksionon në kuadër të E-Office. E-Office është një qendër mësimi, e trajnimeve dhe bizneseve, në bazë virtuale (Techradar, 2021).

E-Office vazhdimisht po përmirësohet prej experteve, duke promovuar mundësi mësimi dhe duke sjellë çështjet etike tek rinia në gjithë botën përmes e-Mësimi apo mësimit elektronik/virtual.

### ***E-librat***

E-librat paraqet një bibliotekë digjitale për ruajtje, kërkim dhe shfletim të librave elektronik shkollorë të dedikuar, para së gjithash, për nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm, por edhe për mësimdhënësit dhe prindërit e tyre. Ideja për vendosjen e portalit është që nxënësve t'u mundësohet shkarkim falas të librave shkollorë në mënyrë që të njëjtit t'u ndihmojnë në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore në një mënyrë novatore dhe interesante, ndërsa mësimdhënësve në përgatitjen dhe prezantimin e materialit mësimor me ndihmën e teknologjive informatike (Ardijana, I. & Ajrullai, A, 2020). Në fillim, librat shkollorë janë botuar në formë të e-librave (ebook), ndërsa në rast se shkarkoheshin, shkarkimi kalojnë në PDF format.

Librat shkollorë janë të ndarë në grupe për arsim fillor dhe të mesëm, ndërsa arsimit i mesëm është ndarë në të mesëm gjimnazi dhe të mesëm profesional. Mirëpo, këtu janë publikuar vetëm libra shkollorë që kanë leje për përdorim në shkollat fillore dhe të mesme, përveç librave shkollorë që departamenti për furnizimin e librave shkollorë nuk është në gjendje t'i publikojë për shkak të mbrojtjes së të drejtave autoriale (Ardijana, I. & Ajrullai, A, 2020). Ndonëse idea është portali të ofrojë qasje deri te librat shkollorë, megjithatë, duhet të mendohet për përmirësimin e gjithë konceptit për libra shkollorë elektronikë, ashtu që në të ardhmen të krijohen libra shkollorë në formë të e-librit (e-book) si dhe audio-libra që veçanërisht janë të rëndësishëm për nxënësit.

### ***Tv-emisionet***

Televizori ndihmon në konkretizimin e informacionit, e bën më të prekshëm atë dhe shmang monotoninë gjatë përvetësimit. Marrja e informacioneve të nxënësve përmes TV kablovikut bëhet përmes shumë shqisave.

Këto informacione mund t'i marrë njëherazi grupi i nxënësve ose edhe individualisht (Ardijana, I. & Ajrullai, A, 2020). Koha e emitimit të emisionit është në kohën e caktuar. Emisioni mund të incizohet (regjistrohet dhe shfrytëzohet më vonë). Bashkëveprimi mund të jetë i kufizuar midis pjesëmarrësve në mësim.

Telekonferencat/konferencat-telefonike: mund të bëhet komunikimi dhe inkuadrimi individual dhe grupor i nxënësve dhe mësimdhënësve (Ardijana, I. & Ajrullai, A, 2020). Koha e shfrytëzimit është e kufizuar, marrja e informacioneve dhe mundësia e komunikimit mund të bëhet në një ose dy drejtime.

### ***Radio-emisionet***

Radio-emisionet shkollore mund të shërbejnë si mësim plotësues, por ka mundësi që edhe organikisht të përfshihen në procesin mësimor. Funkzioni didaktik i radios mbështetet në komunikimin e njëanshëm dhe në përshtypjen individuale auditive. Emisionet e përgaditura mire mund të ndikojnë, jo vetëm në aspektin emotive, por edhe në formimin e qëndrimit kritik ndaj problemit të emisionit. Realizimi i mësimin përmes mjeteve auditive, varet nga përgatitja e arsimtarit për shfrytëzimin efektiv të emisioneve mësimore të radios, siç janë (Vojka-Ismajli, H, 2012):

- Studim i hollsishtëm i përmbajtjeve programore dhe veçimi i njësive të planifikuara për përpunimin, me anën e emisioneve arsimore të radios.
- Njohja e arsimtarit me kohën e emitimit të njësive mësimore të radios.
- Përgatitja e përmbajtjeve të veçanta-plotësuese.
- Sigurimi i kushteve teknike për shfrytëzimin e emisioneve mësimore të radios.
- Organizimi i orës përkatëse të mësimin.

## ***2. Specifikat e organizimit dhe realizimit të mësimit në distancë***

Mësimi në distancë ishte një sfidë e re për gjithë komunitetin shkollor, në mënyrë të veçantë për nxënësit, prindërit, mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave (MASHT, 2020). Mësimdhënësi është mundësuesi në arsimin në distancë, pa mësimdhënësin nuk ka mësimdhënie, andaj mësimdhënia në distancë është veprimtari aktive dhe jo funksion teknik, edhe pse nga largësia. Mësimdhënësit ndihmojnë nxënësit online, me ndihmën e teknologjive të komunikimit, e këshillojnë dhe i japin ide nxënësit në lidhje me objektivat e tij, njëkohësisht duke trajnuar atë, në mënyrë që të mësojë i pavarur. Shkolla (mësonjëtorja) nuk është vendi, mjedisi, i vetëm ku nxënësi mëson.

Mësimi me ndihmën e mjeteve teknologjike mund të realizohet edhe nga shtëpia, gjegjësisht nga mësimi në distancë, nëse ai realizohet mirë, me udhëheqjen dhe ndihmën e mësimdhënësit (të nxënit), përfitimet duhet të ishin të njëjta (MASHT, 2016).

Pra, është mësimdhënësi ai që njohuritë të nxënësi i bartë me ndihmën e teknologjive bashkëkohore të komunikimit, (nuk japin mësim klasik të drejtpërdrejtë në mësonjëtorë, por mësimdhënie me ndihmën e teknologjive nga largësia), planifikojnë dhe organizojnë mësimin, mbështesin dhe përfshijnë nxënësit në bashkëbisedim të vazhdueshëm, japin sqarime, duke mundësuar të kuptuarit e njohurive të reja dhe gjithashtu me anë të teknikave vlerësuese bëhet vlerësimi i performancës së nxënësve.

## ***3. Programet për mësimin në distancë***

Të mësuarit në distancë sot e ka kuptimin e mësimit elektronik. Shkurtesa [e-] e ka domethënien: elektronik. Kështu mësimi elektronik në gjuhën shqipe shkruhet si e-mësim, ndërsa në gjuhën angleze shkruhet e-learning.



E-learning (e-mësimi) është një nga sfidat jo të lehta për korrije të sukseseve në fushën e arsimit. Dihet se mësimnxënia është një proces i vazhdueshëm dhe tepër i rëndësishëm për secilin shtet dhe komb. Ardhmëria e një rinie është pikërisht rezultat i të nxënit.

E gërshetimi i mësimit tradicional me e-learning (e-mësimin) do të përmbajë një konglomerat që do të jetë frytdhënës në shkallën e suksesit shqiptar (Pink H. Daniel, 2014).

Realizimi i e-mësimit (e-learning) bëhet nëpërmjet pajisjeve kompjuterike, të cilat kanë të instaluar programe adekuate, e që në fakt janë softuerë të kompjuterëve (Zhuro, D, 2014).

Deri tani kemi hasur në shumë definicione sa u përket këtyre mjeteve për e-learning (e-mësim), e që në anglisht njihen si: courseware tool. Vetë programet e dizajnuara për këtë qëllim quhen eduweaver.

Ato janë lansuar në tregun e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), ku edhe po gjejnë zbatim jashtëzakonisht të madh. Meqenëse kërkesat për mësim nga distanca janë të mëdha, atëherë edhe angazhimi i ekipeve profesioniste nga fusha e IT-së i është përkushtuar kësaj fushe (Charles, M.C, 2015).

Përmendim disa nga to:

- ✓ Realizimi i procesit mësimor me ndihmën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (Edupoint, 2016).
- ✓ Të dhëna dhe programe të përdorura në trajnim bazuar në kompjuter.
- ✓ Softuer i kompjuterit, i dizajnuar për arsimim.
- ✓ Softuer i dizajnuar për qëllime edukimi.
- ✓ Softuerët për e-learning mund të jenë në CD, ueb-faqe, videoprodukte për instruksione edukative, ose programe për nxënie. Softuerët për e-learning shpesh përdoren edhe për arsimimin e atyre që përdorin kompjuterët, në kurse të ndryshme për gjuhë të huaja, kurse kompjuteri: modulet ECDL, dizajn, uebdizajn, faqosje, pikturim, këndim etj., (Charles, M.C, 2015).

## ***2.6 Rëndësia e të nxënës nga mësimi në distancë***

Mësimi nga distanca, i cili po realizohet nëpërmjet platformës e-mësimi (e-learning) e ka rëndësinë e veçantë. Gjithnjë e më shumë po shihet si një metodë hibride (blended learning) e të mësuarit tradicional, meqë po i plotëson boshllëqet e shumta që i kishte në të kaluarën dhe është duke i rritur rezultatet e suksesit të të nxënës. Për mosarritjen e sukseseve ndër vite, faktorë kyçë ishin dhe mbeten kushtet jo të mira për punë kërkimore, kufizimet e natyrës metodologjike etj. Ndërsa kur ta analizojmë më në detaje kujt i dedikohet kjo metodë e të mësuarit, atëherë mund të radhitim një varg aktorësh që përfitojnë nga ky organizim.

Në rishikim të literaturës, parashihet një rast, i cili falë mësimit në distancë, nëpërmjet videokonferencës në një shkollë fillore në Kroaci, u arrit që të evitohet mbyllja e një shkolle, e ku si rrjedhojë një fëmijë i atij vendbanimi do të mbetet pa u shkolluar për shkak të moshës së tij dhe pamundësisë për udhëtim deri te ndonjë shkollë tjetër. Nxënësit e klasës së pestë i ndoqën mësimet nga distanca nga paralelja e tyre e ndarë në shkollën amë (Vangjeli Gjergji, 2016).

Por, mësimi në distancë do të ketë edhe raste kur fëmijët apo të rriturit për shkak të vështirësive në lëvizje mund t'u ndihmojë që t'i vijojnë mësimet nga distanca (e-learning). Ndërkaq një rëndësi tjetër e veçantë e implementimit të kësaj metode mësimore do të jetë edhe ulja e kostos së shpenzimeve dhe vijueshmëria kohore që nuk do të shkaktojë shpëputje nga puna.

Me gjithë rëndësinë e madhe që e ka kjo metodë e re e të nxënës, shumë analistë dhe profesionistë të fushës së arsimit e shohin nga një kënd tjetër këtë inovacion.

Disa madje shkojnë aq larg së komentuari se kjo platformë do t'i mbyllë përfundimisht shkollat reale (tradicionale). Por, kjo nuk mund dhe nuk do të arrihet (Nikoleta, M, 2013).

Të mësuarit nga distanca nëpërmjet teknologjive të reja me e-mësim (e-learning) dhe m-mësim (m-learnig) ka për qëllim ta plotësojë të nxënës tradicional, ta lehtësojë atë dhe ta bëjë më atraktiv e tërheqës për nxënësit e vet (De Beni. M, 2013).

Ndërsa kur kemi parasysh se të nxënit nëpërmjet e-mësimit është i domosdoshëm edhe për vetë mësimdhënësit dhe të rriturit të tjerë që kanë nevojë për mësim gjatë gjithë jetës, atëherë i eviton të gjitha dilemat se dikush dëshiron të përmbysë diçka që është arritur me shekuj.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjive të reja (TIK) ka ndikuar direkt në avancimin e metodologjive të reja të të nxënit. Kështu të mësuarit virtual do të jetë një pjesë e konglomeratit të përbashkët të procesit pambarimisht të lartë të cilësisë së arsimit dhe për asnjë moment nuk duhet të shihet si i ndarë nga kompleksi i të gjitha të arriturave në fushën e arsimit (Skenderi, S, 2017).

Vendet të cilat ende nuk kanë filluar, apo ato që vetëm janë duke numëruar në vend pa bërë asgjë ende konkrete në drejtim të të nxënit nga distanca, do të duhej që urgjentisht të fillojnë me zbatimin e pilot-projekteve për implementim të e-mësimit (e-learning). Shoqëria jonë kosovare nuk mund t'i mbyllë sytë përballë një nevoje kaq të madhe dhe të përditshme për t'i çuar më tej metodologjitë e reja të të nxënit (MASHT, 2020).

Platformat të cilat janë të specializuara në këtë fushë janë numerikisht të shumta, aq sa na bëjnë ne edhe më të vendosur për ta nisur sa më parë të nxënit në këtë drejtim. Rëndësia në këtë aspekt sigurisht se është e shumtë, për çka kërkohet ngritja e kësaj çështjeje në shoqërinë kosovare për të ndikuar në vendimmarrje qeveritare (Zajazi, T, 2008).

## ***2.7 Epërsitë dhe mangësitë e të mësuarit në distancë***

Nëse parashtrohet pyetja se çka ofron mësimi nga distanca karshi mësimit tradicional, apo cila është arsyeja që në vend të studimeve në shkolla të përcaktohem për mësim online, pa dyshim se ka një varg epërsish. Para se t'i numërojmë disa nga këto përparësi, vlen të theksojmë se të mësuarit nga distanca nuk bie ndesh me të mësuarit tradicional, por e plotësojnë njëri-tjetrin, duke e pasuruar rezultatin përfundimtar të të nxënit, që njëherësh është edhe pikësynim i një mësimdhënësi (MASHT, 2020).

### 2.7.1 Epërsitë që ofron mësimi në distancë:

- ✚ Nuk ka shpenzime për banim dhe shpenzime tjera që kërkohen gjatë studimit tradicional në institucion,
- ✚ Mund të zgjidhet shkolla në të cilën vijon mësimin nxënësi, pavarësisht se në cilin vend ndodhet nxënësi, pa pasur nevojë në ndërrim vendbanimi,
- ✚ E-mësimi mund të ndiqet sipas orarit të cilin e përcakton vetë nxënësi (studenti),
- ✚ Edhe atëherë kur nxënësi (studenti) privohet nga mundësia e pjesëmarrjes fizike në ligjërata, në rastet e sëmundjeve apo pengesave tjera të ndryshme, nëpërmjet platformës e-learning me sukses do të jetë i pranishëm për t'i parë dhe dëgjuar leksionet që i obligon institucioni arsimor,
- ✚ Nëpërmjet e-learning, vetë nxënësi mund ta përcaktojë kohën e studimit, gjë që i jep një relaks dhe motivim shtesë, pa pasur nevojë që ta humbë kohën e tij të çmuar (Zekaj, Xhevdet & Kozma Grillo, 2013).

Përveç kësaj, të mësuarit elektronik e-learning ka edhe përparësi tjera në krahasim me mënyrën e të mësuarit tradicional.

- Nëpërmjet e-mësimit realizohet mësimi gjatë gjithë jetës (Lifelong learning),
- Vijuesit e këtij modeli të të nxënësve janë të pavarur gjatë mësimit, mbajnë tempin e vet dhe vetë e zgjedhin kohën se kur do të “hyjnë në ligjërata”,
- Për një lëndë, që e ofron institucioni arsimor, ata mund të përzgjedhin vetë njërin nga mësimdhënësit e shumtë të asaj lënde,
- Mësimin nga distanca nëpërmjet platformës e-learning mund të zgjidhet të përcillet nga shtëpia, nga vendi i punës, nga pikniku nëpërmjet m-learning (m-mësimi),
- Edhe kur vendbanimi, apo edhe shteti në të cilin jeton studiuesi, nuk e ofron drejtimin e programit që e dëshiron, nëpërmjet e-learning kjo realizohet në kohë reale,
- Mundësohet pjesëmarrja në ligjërata e profesorëve me repute ndërkombëtare, pa pasur nevojë migrimi,
- Përzgjedhja e mënyrës së të mësuarit, aktive apo pasive,

- Edhe mësimdhënësit do të jenë më azhur gjatë gjithë kohës, ngase studentët e tyre parashtrojnë pyetje nga më të ndryshmet, të cilat kërkojnë shkathtësi të veçanta për t'u përgjigjur (Tafani, V & Valva , L, 2016).

### *2.7.2 Mangësitë e të mësuarit në distancë:*

Me gjithë epërsitë e shumta që ka metoda e të mësuarit nga distanca, pa dyshim se ajo i ka edhe mangësitë e veta. Njëloj sikur që pacienti e përdor një medikament, është i vetëdijshëm se ai i ka edhe efektet anësore, për të cilat duhet të njohet paraprakisht, ashtu edhe mësimnxënësi duhet t'i marrë njohuritë bazë për të metat që i ka mësimi në distancë, e-learning.

Platforma e të nxënës nga distanca kërkon shkathtësi të veçanta për ta shfrytëzuar në mënyrë reale tërë atë që e ofron e-mësimi.

Në radhë të parë kërkohet që ai të pajiset me mjetet më të avancuara të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si: kompjuter, internet, kamerë digjitale, kufje, printer, skaner etj. Këto pajisje e kanë koston e vet, por gjithashtu kërkojnë edhe njohuri të avancuara në përdorimin e tyre. Mosnjohja e punës me to, në cilindo stad, e ndërpret ecjen tutje të të nxënës.

Gjithashtu faktor shumë i rëndësishëm është edhe disiplina e rreptë që duhet ta vetëmbajë studiuesi gjatë kohës së ndjekjes së leksioneve, e në veçanti kur ato janë online dhe janë organizuar nëpërmjet video-konferencave (Gaebel, Michael, 2014).

Vetëbesimi dhe vetëmotivimi janë faktorë tjerë, të cilët mund ta ulin apo edhe ta ndërpresin përdorimin e kësaj metode të të nxënës (Carol.C, 2010). Vetëvlerësimi duhet të jetë njëra nga sfidat të cilat nuk është edhe e lehtë të implementohet sa është vetëdija e lartë e studiuesit që ta përcaktojë kohën e përmbushjes së përcjelljes së leksioneve, ushtrimeve dhe debateve tjera të domosdoshme për korrijen e rezultateve gjatë studimit.

### 2.7.3 Sfidat e menaxhimit të arsimit me mësimnxënie nga distanca

Menaxhimi me arsimin është njëra nga sfidat më të mëdha për mesimdhënësit. Ekipet të tëra punojnë dhe vazhdimisht studiojnë për të arritur cilësi në fushën e arsimit. Ardhmëria e një shteti, pikërisht varet nga cilësia në arsim. Kjo nuk paraqet zbulimin e “ujit të nxehtë”. Por, sigurisht se kërkon vëmendje të vazhdueshme për secilin popull, e sidomos për popullin shqiptar, që akoma është larg pikës reale, me të cilën do të vetëkënaqeshim me të arriturat në arsimimin dhe edukimin mbarëkombëtar (Osmani, S, 2016).

Në përmbushjen e planit dhe programit arsimor me mësimnxënie nga distanca, që bazohet në mësimin elektronik, i njohur si e-mësim (e-learning), aktorët që përfshihen jemi pikërisht ne. Kur themi ne, fjala është për:

- Nxënësit, të cilët do të pajisen me dituri të reja, çfarë nuk ka mundur as të paramendohet para disa dekadave,
- Mësimdhënësit, të cilët me metodat e reja, nëpërmjet teknologjive që gati çdo ditë pësojnë avancime, arrijnë me lehtësi dhe në kohë reale ta bartin tërë dijen e nevojshme deri te nxënësit e tyre për programet të cilat i realizojnë,
- Komuniteti, që me vëmendje i përcjell të arriturat dhe ngecjet në arsim dhe
- Prindërit, që mbi supet e tyre e kanë barrën më të rëndë në rast mospasardhësie të pasardhësve të tyre.

Bazuar në gjendjen reale të popullatës kosovare dhe gjendjes që e ka kaluar shekuj me radhë, sigurisht se nuk mund të flasim për një cilësi krahasuese me vendet e zhvilluara. Po ashtu, koha e pasluftës nuk ka i ka dhënë pavarësi të plotë arsimit kosovar (Skenderi, S, 2017). Zhvillimet e hovshme të teknologjive të reja kanë bërë që me shpejtësi të shfaqen edhe nevojat për ndërhyrje në metodat e të nxënësve. Për këtë, të mësuarit nga distanca e ka marrë një formë të prerë të saj, e cila i ka thyer kufijtë e vendeve, duke arritur që t’i ndërtojë të ashtuquajturat “shkollat pa mure”, (Zajazi, T, 2008).

Kjo u ka ndihmuar shumë të gjithë mësimdhënësve që për shkaqe të ndryshme nuk mund të jenë ballë për ballë (face2face) me nxënësit e tyre, përkatësisht studentët, që për shkak të kostove të larta të studimeve në vende të largëta, ka qenë i privuar të studiojë, e prindërit të mos migrojnë për shkak se fëmijët e tyre nuk kanë mundësi shkollimi në vendin ku jetojnë. Por, Kosova në këtë drejtim është mjaft larg. Janë të dhimbshme, ngase vështirë do të pranohen nga kuadrot arsimore, se ata vështirë do t'ia dalin të integrohen me metodat e reja, të cilat janë detyruese për ne, për shkak të zhvillimeve të hovshme që po bëhen në elektronikë (Zhuro, D, 2014).

Këto ndryshime kanë sjellë pajisje të reja, të cilat e ndihmojnë shumë realizimin e mësimnxënies në kohë dhe në vend të ndryshëm.

Secili për vete mund të vendosë, si mësuesi: kur do ta lansojë leksionin e paraparë për nxënësit apo studentët e tij, nxënësi: kur do t'i mësojë leksionet e ofruara nga mësimdhënësi i tij, prindi: kur do t'i kontrollojë notat e fëmijës të tij, komuniteti: e vëzhgon gjithë situatën për t'i dhënë propozimet e reja për ndërhyrje në pikat më të dobëta të mësimnxënies së arritur nëpërmjet teknologjive të reja me e-mësim dhe m-mësim, ndërsa menaxhmenti i institucionit e përcjell realizimin e punës së përditshme të institucionit në ballë të të cilit qëndron (Wright, T, 2015).

#### 2.7.4 Vështirësitë në qasjet teknologjike

Përgjatë përdorimit të teknologjisë në procesin arsimor për mbarëvajtjen e mësimin nëpërmjet internetit janë hasur disa vështirësi të ndryshme e sidomos në fillim. Nxënësit dhe prindërit ishin të shqetësuar se si do të vijonte kjo situatë, si të kyçeshin në platformat e ndryshe, a do të kenë sukses fëmijët e tyre, e disa prindër ishin të shqetësuar si do të ja mundësonin fëmijëve të tyre të ndjekin mësimin me rregull sepse jo të gjithë fëmijët kanë kushtet e përshtatshme për mësim në distancë. Kur themi kushtet e përshtatshme i cekim disa prej tyre:

1. Pajisjet teknologjike (*kompjuteri, telefoni, tableti, etj.*).
2. Njohuri të përgjithshme mbi pajisjet teknologjike etj.

Tek kushtet e sipër përmendur ka shpjegime të qarta që duhet të plotësohen, pra jo secili nxënës ka mundësi që ta ketë kompjuterin e vetë ose pajisjet e tjera teknologjike sepse kushtet ekonomike luajnë rol në këtë pjesë, gjendja ekonomike në vendin tonë nuk i plotëson kushtet që secili fëmijë të posedojë një pajisje teknologjike personale (Robbins P.Stephen, 2014). Faktori i dytë njohurit e përgjithshme mbi pajisjet teknologjike dihet se jo çdo fëmijë ose prindër kanë njohuri për mënyrën e aplikimit të kësaj forme të mësimin në distancë. Mund të theksojmë se kjo ishte problem vetëm për gjatë pjesës fillestare sepse me kohë jo vetëm prindërit por edhe fëmijët e mësuan mënyrën e aplikimit për tu lidhur në mësim.

### *2.7.5 Problemet gjatë mësimin në distancë*

Gjatë procesit mësimorë problemet nuk kanë munguar. Jo vetëm për nxënës por edhe për mësimdhënësit, në këtë pjesë nuk hynë vetëm problemet teknologjike por edhe problemet nga jeta e përditshme aspekti kohor, cilësia e mësimin, shkalla e interesimit të nxënësit (Mattheis, C, 2012).

Në këtë pjesë rëndësi të veçantë duhet kushtuar nxënësve të ciklit të ulët nga klasa parë deri në të pestë, sepse kjo fazë e shkollimit të tyre është themeli i ndërtimit të dijes së tyre dhe nëse ne sot gjatë mësimdhënies kemi mësim jo efektiv dhe mësimnxënia tek nxënësit është në nivel të ulët atëherë pasojat do ti bartin nxënësit gjatë gjithë jetës.

Problemet tjera janë të ndryshme me të cilat janë përballur edhe nxënësit si p.sh:

- Ngarkesa nga detyrat të shumta.
- Përqendrimi jo adekuat në mësimin përmes klasës virtuale.
- Mos hapësira e mjaftueshme për të kërkuar shpjegim shtesë.
- Mungesa e pajisjeve teknologjike në shtëpi.
- Mbyllja ose izolimi në shtëpi.



Nga të gjitha problemet e latë cekura mund të themi se janë vetëm disa nga të shumtat. Me të filluar nga ngarkesa e madhe e detyrave të shtëpisë, që nxënësi udhëzohet ti kryej në disa raste nga pa mundësia kohore të përfundohen brenda afatit kohorë të mbajtjes së mësimit nxënësit detyrohen ti plotësojnë vetë edhe ato pjesët të cilat janë të pa qarta (MASHT, 2020).

Natyra e fëmijëve sjell në një situatë ku përqendrimi i tyre në procesin e intervalit kohorë të jetë i shkurtër për mësim dhe bënë që shpjegimet shtesë që u nevojiten nxënësve të lihen anash, edhe pse janë faktor i rëndësishëm për mësimnxënie (Zhuro, D, 2014).

Në vendin tonë siç e dimë kushtet ekonomike bënë që pajisjet teknologjike shpesh herë të mungojnë ose të ketë vetëm një pasje teknologjike në shtëpi, ndërsa në familje janë tri ose më shumë fëmijë të cilët detyrimisht duhet që në intervale të njëjta kohore të kyçen në mësim, kjo është problemi që ka prekur shumë nxënës.

Bota e fëmijëve në një ambient të mbyllur sjellë disa probleme të vogla sepse kërkesa e tyre për të vazhduar një jetë të lirë bënë që të mos e kuptoj situatën në të cilën ndodhemi, e kjo ka bërë që pajisjet teknologjike të hynë në një përdorim më të madhe jo vetëm për mësim online por edhe për pjesën e argëtimit të fëmijëve përmes lojërave të ndryshme, që jo rrallë herë kanë rënë pre e varësisë nga pajisjet teknologjike duke lënë anash interesimin për mësim (Qafa. A, 2014).

#### *2.7.6 Vështirësitë e mësimdhënësit*

Ky proces ishte risi edhe për vetë mësimdhënësit të cilët nuk ishin hasur ndonjëherë me këtë formë duke përdorur pajisjet teknologjike, vetë shpjegimi dhe sqarimi i gjërave të pakuptueshme për nxënësit nxirrnin në pah vështirësitë e të nxënit.

Vështirësitë tjera ishin:

- ✓ Mënyra e menaxhimit të orëve mësimore.
- ✓ Krijimi i mundësisë së qasjes së të gjithë nxënësve në të njëjtën kohë.

- ✓ Shpjegimi i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë.
- ✓ Më e rëndësishmja vlerësimi i nxënësve (Mc Queen, Th, 2012).

Menaxhimi i orëve mësimore ishte sfidë në vete sepse gjatë mësimit në objektet shkollore për disa mësimdhënës cilësohet si problem i pamungueshëm.

Arsyet janë nga më të ndryshmet si p.sh.:

- ✓ Materialet mësimore teje të ngjeshura.
- ✓ Aspekti kohorë i një ore mësimore i pamjaftueshëm.
- ✓ Numri i madh i nxënësve në klasa (MASHT, 2020).

Këto arsyeje përcjellin edhe në mësimin në distancë. Në disa raste jo të pakta materialet mësimore janë shumë të ngjeshura krijojnë mëdyshje tek nxënësit që përcjellën me paqartësi, e në rastin e mësimit në distancë në mungesë të kontaktit fizikë mënyra e qartësimit të tyre merr drejtim tjetër. Marrja e shembujve dhe sqarimi i problemeve është i parealizueshëm.

Vlerësimi i nxënësve në pjesën e lartë cekur konsiderohet si vështirësi. Vështirësia qëndron në pjesën ku vlerësimi duhet të jetë i përditshëm dhe i vazhdueshëm (Nikoleta, M, 2013). “Por të vlerësojmë çdo mënyrë të sjelluri, të vepruari të nxënësit, me një fjalë aftësitë e tyre të përgjithshme“.

### III. PLATFORMA E MËSIMIT NË DISTANCË

#### *3.1 Platformat teknologjike të mësimit në distancë*

Platformat digjitale janë ato të cilat e bëjnë më të lehtë punën për mësime për mësuesit që të menaxhojnë mësimin në distancë. Sistemet e Menaxhimit të Mësimit (LMS) dhe Mjediset Virtuale të Mësimit (VLE) janë bërë gjithnjë e më të zakonshme (Techradar, 2021), veçanërisht për shkak të ndryshimeve gjithëpërfshirëse arsimore që u bënë të nevojshme për shkak të pandemisë.

Për dallim nga mësimi fizik, platformat e ndryshme digjitale gjithnjë e më shumë po ofrojnë mundësi që mësimi dhe kurset të ndryshme të zhvillohen përmes tyre. Kjo metodë mund të jetë më e lirë dhe më e lehtë për t'u menaxhuar për mësime për mësuesit sepse mundëson qasje të lehtë për mbajtjen e mësimit nga distanca (Techradar, 2021). Në një kohë të largët, platformat e të mësuarit në distancë ishin më pak të përdorura por tani sa më shumë që po përdoret teknologjia moderne po ashtu po përdoren edhe platformat e ndryshme për arsimin në distancë.

Kjo nuk do të thotë se mjetet e mësimit fizik janë gati të zhduken, por institucionet arsimore kanë identifikuar se njerëzit mund të arrijmë shumë më tepër përmes teknologjisë, me paisje si telefonat inteligjentë dhe pajisje të tjera të cilat kanë mundësi të lidhen me internet dhe të cilat mundësojnë mësimin në distancë nga çdo vend.

Platformat e mësimit në distancë vitet e fundit janë bërë shumë më të larmishme, kështu që për të mësuar një gjuhë ne mund të përdorim aplikacione për mësimin e gjuhës dhe të çertifkohemi po nga ajo platformë (Platform-e-learning, 2020), dhe për më të rinjtë përveç mësimit në distancë ka edhe shërbime të tjera në lidhje me trajnime të fushave të ndryshme si platforma kodimi, programimi e shumë të tjera.

Platforma përputhet me një sërë standardesh që u mundësojnë zhvilluesve të softuerit të zhvillojnë aplikacione softuerike për platformën. Të njëjtat standarde i lejojnë njerëzit ti blejnë këto aplikacione për qellimet e tyre (Platform-e-learning, 2020). Ndërfaqet e reja të bazuara në standarde teknologjike dhe ndërfaqet e hapura lejojnë që programet e aplikacioneve të ekzekutohen në platforma të shumta. Për më tepër, zhvilluesit e softuerit kanë zhvilluar mjete softuerike që lejojnë aplikacionet të ekzekutohen në platforma të ndryshme.

Platformat dixhitale janë mjete të fuqishme për të mbështetur dhe zgjeruar ndryshimet e paradigme. Një platformë dixhitale mund të krijojë dhe analizoj të dhëna që ofron mbështetje për mësimin në distancë në kohë reale. Kjo është shumë e rëndësishme në dy nivelet personale dhe kolektive (Technology&Digital Platforms-Learnlife, 2020). Platformat dixhitale janë rrugët më mira që nxënësit të zhvillojnë mësimin nga distanca. “Teknologjia në arsim duhet të jetë sikur ajri e padukshme por jetike dhe gjithmonë e pranishme, prandaj platformat teknologjike na ofrojnë ndryshimin” (Platform-e-learning, 2020).

Meqenëse teknologjia vazhdon të evoluojë vazhdimisht, nuk ka kuptim të shikojmë teknologjinë aktuale si një pikë përfundimtare, por si një hap tjetër drejt inovacionit të mëtejshëm. Ndikimi i teknologjisë në mësimin në distancë (e-learning) nuk varet vetëm nga softuerët po edhe njohuritë tona për të krijuar platforma të nevojshme për mësimin në distancë (Technology&Digital Platforms-Learnlife, 2020). Në të kaluarën ne mbështeteshim vetëm te ndihma e mësimdhënësit për të marrë dhe shpërndar informacione, ndërsa sot me ndihmen e teknologjisë dhe platformave teknologjike kemi një oqean të pafund të njohurish.

Platformat që kemi sot në dispozicion të mësimdhënësve dhe të nxënësve kanë shfaqur një dinamik të re për mësimdhënien dhe të nxënësve, prandaj platformat teknologjike nuk e bëjnë të vjetruar rolin e mësimdhënësit por në fakt mësimdhënësit luajnë një rol të rëndësishëm në rrugën e mësimin në distancë (Platform-e-learning, 2020). Nxënësit duhet të udhëhiqen nga mësimdhënësit për të avancuar njohurit e tyre me fokus në aftësitë kryesore si inovacioni, bashkëpunimi, komunikimi dhe të menduarit kritik përmes platformave teknologjike.

Deri vonë në institucionet kosovare, të mësuarit elektronik nuk është prezentuar dhe shfaqur si nevojë për shoqërinë kosovare, kur dihet se një prej pikave kryesore të zhvillimit arsimor të shoqërisë është edhe të mësuarit në distancë. Mënyra e mbajtjes së mësimit ditëve të sotme ka pasur ndryshime të mëdha duke kaluar nga mësimi klasik në bankat shkollore në mësim në distancë si platformë ndryshe (Platform-e-learning, 2020). Një nder të mirat e shumta që na ka ofruar teknologjia në këtë kohë janë edhe këto platformat e ndryshme në të cilat është zhvilluar mësimi gjatë kësaj kohe. Në fillim një pikëpyetje e madhe ka qenë se cila prej platformave ekzistuese është më e lehtë për përdorim, jo çdo mësimdhënës përdorë platformën e njëjtë.

Për të realizuar mësimin në distancë, mësimdhënësit e shkollave të arsimit fillor në vendin tonë kanë gjetur mënyrat më të përshtatshme për të kontaktuar me nxënësit, përmes aplikacioneve të ndryshme online, të cilat i kanë shërbyer për të komunikuar dhe për të bashkëvepruar me njëri tjetrin, për menaxhimin e detyrave dhe shërbime të tjera arsimore.

Arsimi në distancë është proces i mësimdhënies nga largësia, që realizohet nga mësimdhënësi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, në mënyrë sinkrone, si grupe trajnimi virtuale, komunikime në kohë reale (chat), platformën ZOOM dhe vidiokonferencat, ku të gjithë nxënësit, në të njëjtën kohë, marrin pjesë në diskutim dhe përfitojnë nga diskutimi në grup me nxënësit e tjerë. Interaksioni personal është i rëndësishëm për një klasë online (Technology&Digital Platforms-Learnlife, 2020). Platforma online u lejon nxënësve të “dëgjojnë” pyetjet dhe përgjigjet, u ndihmon të gjithëve të kuptojnë më mirë dhe i inkurajon që të parashtrajnë pyetje tjera, si dhe në mënyrë asinkrone, ku secili nxënës ka qasje në mësimin elektronik, si e-mail, programe interneti ndëraktive dhe shkarkimi i materialeve audio ose video, por kohën e inkuadrimit e përcakton vetë dhe punon sipas ritmit të tij, pra nuk e ndien presionin e kohës.

Të mësuarit online në distancë, përveç në mënyrë sinkrone dhe asinkrone, ofrohet edhe si mësim hibrid (i përzier), alternativim i mësimit të drejtpërdrejtë dhe atij online, me ndërmjetësimin e teknologjisë, ku mësimdhënësi dhe nxënësit ndodhen në largësi një pjesë të kohës (Platform-e-learning, 2020).

Përdorimi i mësimit online, duke zgjedhur midis alternativave të ndryshme (mësimi online sinkron, asinkron dhe i përzier) nga potencialet e teknologjisë aktuale, lejon krijimin e një ambienti të nxënies për një numër të madh të nxënësve, duke i shkarkuar problemet e ballafaquara në distancë gjeografike dhe duke u përfshirë në një pjesëmarrje shumë të lartë interaktive.

Brenda mësimit sinkron, mësimdhënia dhe të mësimit zhvillohet në kohë reale (në të njejten kohë), ndërsa mësimdhënësi dhe nxënësit janë të ndarë fizikisht nga njeri-tjetri (Techradar, 2021). Shembujt përfshijnë: dëgjimin e një transmetimi në radio, mundësia për të shikuar drejtpërdrejt një transmetim televiziv, audio dhe video konferenc etj. Karakteristikë për mësimin josinkronik është fakti se mësimdhënësi e përgadit materialin e kursit para se kursi të zhvillohet. Nxënësi është i lirë të vendosë kur ai dëshiron të ndjekë kursin.

Përparësitë e kësaj platforme janë: përdorimi i teknologjisë për të mësuar, krijuar dhe bartur të dhëna, kudo dhe në çdo kohë, mundësia për të mos paguar për hapësirat shkollore dhe infrastrukturaes gjithashtu, program dinamik i të mësuarit, i cili krijuar një lidhje në mes të nxënësve dhe profesorëve në mënyrë elektronike, komponentë shtesë e cila i jep nxënësve dhe shkollës frymë konkurruese me sfidat botërore përmes informative më të azhuruara që dalin prej kësaj platforme.

Mangësitë janë: vlerësimi i punës së çdo nxënësi është më e kompletuar pasi nxënësi nuk është afer (përballë) mësimdhënësit dhe mundësia për ndihmë nga dikush apo kopjim është më e lehtë, disiplina në mësim është më e vështirë për tu mbajtur, pasi nxënësi kur është më afër apo përballë mësimdhënësit mundet më lehtë t'i ndihmohet për paqartësitë e tij por edhe të stimulohet për mësim gjithashtu, komunikimi mbetet më zyrtar në mes të nxënësit dhe mësimdhënësit (Techradar, 2021), është shumë rrezik që të mos kuptohen në mes vete.

Gjatë mësimit në distancë, përgatitja për mbrojtjen e një qëndrimi të caktuar zakonisht bëhet në mënyrë asinkrone, kështu që secili nxënës hulumton dhe analizon burime të informacioneve për tezën që duhet ta përfaqësojë, me mundësi për komunikim të kohëpaskohshëm në nivel të ekipeve dhe ndjekje të procesit nga mësimdhënësi.

Zhvillimi i platformave digjitale për përdorim në procesin mësimor Ministria e Arsimit, Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), vite më parë, e ka prezantuar si prioritet me interes dhe si mundësi të mirë për zbatim të kurrikulës së re (MASHTI, 2020). Mirëpo, kjo nuk është arritur të bëhet përmes një sistemi, i cili do të ofronte mundësi, qasje dhe përdorim të lehtë nga të gjithë. Në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID–19, është ndërprerë mësimi në të gjitha nivelet e sistemit tonë arsimor dhe u paraqit nevoja për organizimin e mësimin në distancë/e-mësimin, për të gjithë nxënësit e Kosovës.

Në përgjigje të rrethanave të krijuara, MASHTI, ashtu si sistemet tjera arsimore në Evropë dhe më gjerë, menjëherë ka filluar punën rreth organizimit të procesit të mësimin në distancë/e-mësimin. Me mbështetje të disa operatorëve ekonomikë, nga fusha e ICT-së, mediave dhe ofruesve të shërbimeve arsimore, si dhe bazuar në kapacitetet infrastrukturore dhe ekspertizës profesionale, MASHTI ka krijuar platformën për mësimin online në Kosovë (<https://emesimi.rks-gov.net>, n.d.) dhe janë duke u publikuar materialet mësimore të hartuara nga mësimdhënës dhe ekspertë të angazhuar. Gjithashtu, është krijuar edhe vegëza për kanalin e MASHTI-t në ‘YouTube’ dhe materialet janë organizuar sipas klasave. Transmetimi i këtyre materialeve bëhet në orare të caktuara edhe në Radio Televizionin e Kosovës - RTK1 dhe RTK4 (ritransmetim).

Për realizimin me sukses të mësimin në distancë, MASHTI ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e nivelit qendror (MASHTI-t), DKA-ve, shkollave dhe mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, si dhe u ka kërkuar që të vazhdojnë obligimet profesionale të gjitha instancave dhe individëve të sistemit arsimor kosovar (MASHTI, 2020), duke përfshirë edhe përvojat e mira të realizimit të mësimin online nga programe dhe platforma që janë lejuar nga MASHTI për institucionet arsimore publike, si School Me, Projekti e-edukimi etj.

MASHTI, nga viti 2009, ka bërë përpjekje për integrim të TIK-ut në mësimdhënie dhe atë përmes dokumenteve strategjike dhe disa projekteve, të financuara nga fondet qeveritare dhe nga donatorët e ndryshëm.

Në mesin e këtyre projekteve vlen të përmenden projekti për trajnim të mësimdhënësve në programin ECDL, projekti i Bashkimit Evropian për mësim elektronik, Programi Bazik i Arsimit, Projekti e-edukimi, projekti me KEC për platformën School Me etj.

Në kuadër të objektivës së pestë strategjike të PSAK 2017-2021, (MASHT, 2016), që u referohet mësimdhënies dhe të nxënësve, MASHTI ka paraparë disa aktivitete, të cilat do të mundësojnë shfrytëzimin e teknologjisë digjitale në procesin mësimor, si: trajnimin e mësimdhënësve për zhvillimin dhe shfrytëzimin e materialeve elektronike, sigurimin e rrjeteve lokale që mbulojnë hapësirat ku zhvillohet procesi mësimor në shkollat, sigurimin e qasjes në internet për të gjitha shkollat etj.

Kështu hap pas hapi filloi edhe lansimi i platformave që ofrojnë shërbime arsimore teknologjike nga ekspert të fushës së TIK-ut dhe të angazhuar nga MASHT-i, dhe platformat kryesore për zhvillimin e mësimin në distancë për shkollat fillore janë:

### ***3.2 Google Classroom***

Është platformë për mësim online që mundëson klasat në internet. Mundëson që mësimdhënësit të krijojnë dhe shkëmbejnë përmbajtje dhe dokumente përveç krijimit, komentimit të detyrave (Techradar, 2021). Nxënësit mund të gjejnë një arkivë të mësimëve me prezantime në PowerPoint, udhëzime për mësim dhe projekte ndërvepruese.

Gjithashtu në ‘Google Classroom’ mund të krijohen klasa individuale ku mund të përfshihen:

- Detyrat dhe pyetjet e mësuesve.
- Temat e organizuara në module ose njësi.
- Mundësi për bashkëpunim me nxënës të tjerë.
- Programi i takimeve në Google Calendar.



- Dosje të klasës, e cila përfshin prezantimet dhe projektet PowerPoint nga nxënësit.
- Materiale të bashkangjitura mësimore dhe burime në internet.
- Secili nxënës mund të marrë përshtypje personale nga mësuesit e tyre në lidhje me detyrat e tyre.

### **3.3 MEET**

MEET është një platformë në kuadër të GoogleApps, kjo platformë lejon mbajtën e konferencave ose mësimin në kohë reale pra përmes qasjes në të. Kjo platformë është më shumë e aplikueshme për mbajtën e mësimin në nivele më të larta të arsimit, si çdo platformë tjetër është kjo platformë lejon lidhjen me video lidhje, bisedës vetëm me zë ose vetëm duke shkruar në pjesën e rezervuar për bisedë (Techradar, 2021).

Mësimdhënësi pas qasjes në Google Meet të tij personal krijon klasën virtuale dhe u shpërndanë nxënësve lidhëzën ose ndryshe likun për tu kyçur në klasë virtuale. Është platformë e lehtë për tu përdorur përveç ndonjë vështirësie eventuale për kyçje ose rrjetin kompjuterik. Njëkohësisht ka mundësi kyçje në kompjuter, telefon të mençur ose tablet (The Peace Corps, 2020).

### **3.4 Skype**

Është një nga platformat e para që e transformoi komunikimin video duke ofruar komunikim falas që nga viti 2003. Për ta përdorur, mjafton të instaloni aplikacionin në kompjuterin apo smartphone dhe duke krijuar një llogari ju mund të lidheni lehtësisht me një apo disa persona njëherazi (Techradar, 2021). Kjo platformë është mjaft e njohur kudo.

### ***3.5 Posta elektronike***

Përdoret për komunikime dhe njoftime kryesore, duke përfshirë edhe ato të drejtorisë së shkollës. Stafit gjithashtu përdor email-et për të komunikuar me njëri-tjetrin por edhe në komunikimin me nxënësit megjithëse duhet të përdorin edhe platforma të tjera (shitesë) për të bashkëvepruar me nxënësit e tyre (Techradar, 2021). Në disa raste, mesazhet mund të dërgohen me email si video inçizime.

### ***3.6 ZOOM***

Zoom është një mjet komunikimi me video i ngjashëm me Skype apo Google Hangouts. Është një faqe e bazuar në video konferenca e cila realizohet përmes kompjuterit dhe aplikacion për telefonat celularë që lejon përdoruesit të takohen, komunikojnë online.

Për mësimdhënësit, versioni falas i Zoom ofron mundësinë e krijimit të një ore mësimi deri në 100 nxënës, dhe i lejon nxënësit të sinjalizojnë mësimdhënësin pa fjalë nëse ata kanë një pyetje, i lejon nxënësit të ndërveprojnë në një dërrasë virtuale (whiteboard), dhe të bashkëpunojnë në projekte duke bërë shënime në dokumente, në ekranet e nxënësve të tjerë (Techradar, 2021). Një kufizim i versionit falas të Zoom është që lejon që orët e mësimit të jenë vetëm 40 minuta. Sidoqoftë, një version me pagesë i Zoom mund të bëjë të mundur dhe heqjen e kufizimit prej 40 minutash për një takim.

Zoom mund të përdoret me pothuajse çdo pajisje, duke përfshirë një smartphone (për aq kohë sa ajo ka një kamera). Aplikacioni Zoom shkarkohet në Apple Store ose Google Play. Mund të kyçeni në llogarinë tuaj edhe nga një qendër interneti. (Techradar, 2021). Mësimdhënësi kur krijon klasën dërgon ID-në e takimit 11-shifror ose link-un, përmes të cilit nxënësit do të bashkohen në orën e mësimit.

Avantazhet e kësaj platforme janë: Platformë shumë e qëndrueshme që mund të akomodojë lehtësisht një, dhjetëra dhe qindra përdorues në të njëjtën kohë nga e gjithë bota, ofron mjaft integritime që ju ndihmojnë me organizimin e takimeve, konferencave dhe webinarëve pavarësisht vendndodhjes, shumë integritime të tjera dhe opsione për marketing.

Disavantazhet janë: Kërkon pak kohë për nga përdoruesi për t'u familjarizuar me platformën, numër i kufizuar personash që mund të bashkëveprojnë në të njëjtën kohë për opsionet pa pagesë, nuk ofron transmetim me rezolucion 4K si Click Meeting (Techradar, 2021).

## **IV METODOLOGJIA**

Ky është një hulumtim në të cilin kam analizuar veçantitë e organizimit dhe menaxhimit në klasë dhe mësimin në distance në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet. Hulumtimi është kryer në shkollat fillore në qytetin e Vushtrrisë. Qasja kërkimore e këtij hulumtimi është i përzier për faktin se pyetjeve të hulumtimit mund t'u jepet përgjigje më mirë përmes dy llojeve të të dhënave. Hulumtimin e kam bërë me mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit e shkollave fillore pikërishtë klasat IV deri në të V. Në procesin për përpunimin e të dhënave jam mbështetur në të dhënat statistikore numerike të cilat janë prezantuar përmes analizave statistikore të përpunuara në softuerët apo teknologjitë softuerike të fundit siç është SPSS dhe Microsoft Excel 2016.

### ***4.1 Popullacioni dhe mostra e hulumtimit***

Hulumtimi është fokusuar me mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit e shkollave fillore në qytetin e Vushtrrisë. Mostra e përzgjedhur për këtë hulumtim do të jetë 180 anketues tek të cilët do të shpërndajmë pyetësin për realizimin e hulumtimit.

### ***4.2 Instrumentet e hulumtimit***

Instrumenti i përdorur për këtë hulumtim do të jetë pyetësi i cili do të shpërndahet te mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit e shkollave fillore. Ky instrument do të ndahet kryesisht në tri pjesë siç është pjesa demografike, pjesa e dytë me njohuritë si dhe pjesa e tretë me pyetje që masin ngjajshmëritë dhe dallimet në organizimin dhe menaxhimin e mësimin në klasë dhe mësimin në distancë në klasat IV-V të shkollave fillore.

### ***4.3 Procedurat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave***

Pasi të miratohet projekt propozimi fillimisht do të fillojmë me shfrytëzimin e literaturës dhe hulumtimin e materialeve arkivistike, pas kësaj do të shpërndajmë pytesorin tek mësimitdhënësit, prindërit dhe nxënësit e shkollave fillore për të filluar me hulumtimin.

Pas plotësimit të pyetësorëve të dhënat do të vendosen në një bazë të të dhënave të cilën më pastaj do ti vendosim të gjitha në SPSS për t'i analizuar. Të dhënat do të analizohen me softuerin për analiza statistikore të shkencave sociale - SPSS 23, dhe do të përdoren analiza deskriptive, e besueshmërisë, korelacionare, regresioni dhe T-testi si dhe do të bëhet një paraqitje grafike e shpërndarjes së tyre.

### ***4.4 Rezultatet e pritura***

- Identifikohen opinionet për specifikat e organizimit në distancë.
- Vërtetohet se nuk ka të përbashkëta ndërmjet mësimitdhënies në klasë dhe mësimitdhënies në distancë.
- Konstatohet dallimi në mes mësimit në klasë dhe mësimit në distancë dhe vlerësohet se sa mësimitdhënësit janë të trajnuar për të zbatuar mësimin në distancë në rrethana të pandemisë Covid-19

## V ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

### 5.1 Analiza deskriptive e të dhënave demografike të mësimdhënësve

Analiza deskriptive e cila është përdorur për përshkrimin e të dhënave demografike të mësimdhënësve, është paraqitur në Tabelën 1. Të dhënat demografike të 20 mësimdhënësve të anketuar janë shprehur në numër dhe në përqindje.


**Tabela 1.** Analiza deskriptive e të dhënave demografike të mësimdhënësve

<b>GJINIA</b>	<b>N</b>	<b>%</b>	<b>MOSHA</b>	<b>N</b>	<b>%</b>	<b>VENDBANIMI</b>	<b>N</b>	<b>%</b>	<b>NIVELI I ARSIMIT</b>	<b>N</b>	<b>%</b>
Femër	17	84	30 e më pak	8	40	Urban	14	82	Bachelor	16	80
Mashkull	3	16	31-40	6	30	Rural	6	18	Master	4	20
			41-50	4	20						
			Mbi 50 vjeç	2	10						

Nga analiza korrelacionare në Tabelën 1., shohim se sa i përket gjinisë së mësimdhënësve kemi këtë rezultat, 84% e të mësimdhënësve të anketuar i përkasin gjinisë femërore dhe 16% gjinisë mashkullore. Vendbanimi luan një rol të rëndësishëm në problemin që po elaborojmë për shkak që vendbanimi urban ofron më shumë mundësi për qasje në paisjet teknologjike për të zhvilluar mësimin në distancë në krahasim me vendbanimin rural e kjo ndikon shumë në organizimin e mëimit në distancë, edhe në përgjigjen e respondentëve të anketuar nga 20 mësimdhënësit sa ishin gjithësejt 82% prej tyre jetojnë në qytet dhe 18% e respondentëve jetojnë në fshat.


Mosha e mësimdhënësve të anketuar sipas rezultatit në Tabelën 1., është 40% i takojnë moshës 30 e më pak vjeç, 30% i takojnë moshës 31-40 vjeç, 20% i takojnë moshës 41-50 vjeç dhe 10% i takojnë moshës mbi 50 vjeç. Nga rezultatet e moshes së mësimdhënësve të anketuar mund të konkludojmë se sipas moshes së re të tyre nuk kanë hasur në ndonjë vështirësi në menaxhimin dhe organizimin e mësimit në distancë duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe përdorimit të shumtë të tij në të gjithë botën po ashtu edhe tek ne.

Sa i përket shkollimit të mësimdhënësve nga tabela kemi këtë rezultat, 80% e mësimdhënësve të anketuar kanë shkollimin bachelor dhe 20% e mësimdhënësve të anketuar kanë shkollimin master.




**Figura 1.** Klasat në të cilat japin mësim mësimdhënësit.

Sipas rezultatit në figuren 1., shohim se 60% e mësimdhënësve të anketuar japin mësim në klasat e katërta ndërsa 40% e mësimdhënësve kanë deklaruar që japin mësim në klasat e pesta. Nga kjo mund të kuptojmë që mësimdhënësit e anketuar të cilët kanë zhvilluar mësimin në klasë dhe mësimin në distancë kanë pasur mjaft probleme sepse nuk kanë qenë më herët të përgaditur për të zhvilluar mësim në distancë dhe kjo situatë ka ndikuar negativisht te mësimdhënësi sepse nuk kanë mundur ta menaxhojnë dhe organizojnë në mënyrën më të mirë orën gjatë mësimit në distancë krahasuar me mësimin në klasë të cilën e ka ma të lehtë ta menaxhojë.



**Figura 2.** *Preferenca e mësimeve lidhur me mësimin në klasë dhe mësimin në distancë*


Gjithmonë duke u bazuar në përgjigjet e mësimeve shohim se mësimi në klasë është ende më i preferuar tek mësimeve sepse kështu janë deklaruar 94% e mësimeve të anketuar, ndërsa 6% e mësimeve të anketuar kanë deklaruar se më shumë e preferojnë mësimin në distancë. Nga këto rezultate kuptojmë se mësimeve janë më të sigurtë në organizimin dhe menaxhimin e mësimin në klasë.



**Figura 3.** *Menaxhimi më i lehtë i orës mësimore nga mësimeve*


Menaxhimi i orës mësimore është dhe do të mbetet sfidë për mësimeve, këtë na e dëshmuar edhe mësimeve e anketuar ku 80% e mësimeve të anketuar kanë thënë se më mirë e menaxhojnë mësimin në klasë me nxënësit e tyre ndërsa 20% e tyre kanë thënë se më mirë e menaxhojnë mësimin në distancë me nxënësit e tyre.






**Figura 4.** Vështirësitë e mësimit lidhur me përdorimin e mjeteve teknologjike gjatë mësimit në distancë

Rezultatet në figurë na tregojnë se disa nga mësimit e anketuar kishin hasur në vështirësi në përdorimin e mjeteve teknologjike për të zhvilluar mësimit në distancë, kështu që 90% e mësimit të anketuar kanë deklaruar se kanë pasur problem gjatë përdorimit të mjeteve teknologjike ndërsa 10% e mësimit kanë deklaruar se nuk kanë pasur problem gjatë përdorimit të mjeteve teknologjike për të zhvilluar mësimit në distancë.




**Figura 5.** Vështirësitë në vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë

Mësimit e anketuar janë përgjigjur edhe në pyetjen e radhës se sa kanë pasur vështirësi në vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë dhe sipas grafikonit kemi këtë përgjigje, 87% e mësimit kanë deklaruar se kanë pasur vështirësi në vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë dhe 13% e mësimit të anketuar kanë deklaruar se jo nuk kanë pasur vështirësi në vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë.



**Figura 6.** Njohuritë e mësimeve për programet që mundësojnë mësimin në distancë

Programet që mundësojnë mësimin në distancë janë mjaft sfidues për të gjithë poashtu edhe për mësuesit sepse nuk është ndonjë dukuri që është praktikuar në masë të madhe në vendin tonë përderisa nuk u përballim me pandeminë Covid 19, kështu që 70% nga mësuesit e anketuar kanë thënë se nuk kanë pasur njohuri për programet që mundësojnë mësimin në distancë ndërsa 30% e mësimeve kanë thënë se kanë pasur njohuri për programet që mundësojnë mësimin në distancë.



**Figura 7.** Të dhënat për nxënësit se sa kanë ndjekur mësimin në distancë

Të dhënat nga figura na tregojnë se 80% e mësimeve të anketuar kanë thënë se gjatë kohës sa kanë zhvilluar mësimin në distancë kanë pasur rregullisht nxënës të cilët nuk e kanë ndjekur mësimin në distancë dhe 20% mësimeve të anketuar kanë thënë se jo nuk kanë pasur ndonjë nxënës i cili nuk ka vijuar mësimin në distancë

## 5.2 Analiza deskriptive e të dhënave demografike të prindërve

Analiza deskriptive e cila është përdorur për përshkrimin e të dhënave demografike të prindërve, është paraqitur në Tabelën 2. Të dhënat demografike të 80 prindërve të anketuar janë shprehur në numër dhe në përqindje.


**Tabela 2.** Analiza deskriptive e të dhënave demografike të prindërve

<b>GJINIA</b>	<b>N</b>	<b>%</b>	<b>MOSHA</b>	<b>N</b>	<b>%</b>	<b>VENDBANIMI</b>	<b>N</b>	<b>%</b>	<b>NIVELI I ARSIMIT</b>	<b>N</b>	<b>%</b>
Femër	54	67	30 e më pak	32	40	Urban	69	86	Bachelor	64	80
Mashkull	26	33	31-40	37	46	Rural	11	14	Master	11	14
			41-50	8	10				Doktoratur	5	6
			Mbi 50 vjeç	3	4						

Nga analiza korrelacionare në Tabelën 2., shohim se sa i përket gjinisë së prindërve kemi këtë rezultat, 67% e prindërve të anketuar i përkasin gjinisë femërore dhe 33% gjinisë mashkullore. Sa i përket vendbanimit kemi këtë rezultat, nga të gjithë prindërit e anketuar 80 prindërit sa ishin gjithsejt 86% prej tyre jetojnë në qytet dhe 14% e respondentëve jetojnë në fshat.


Mosha e mësimdhënësve të anketuar sipas rezultatit në Tabelën 2., është 40% i takojnë moshës 30 e më pak vjeç, 46% i takojnë moshës 31-40 vjeç, 10% i takojnë moshës 41-50 vjeç dhe 4% i takojnë moshës mbi 50 vjeç.

Sa i përket shkollimit të prindërve nga tabela kemi këtë rezultat, 80% e prindërve të anketuar kanë shkollimin bachelor dhe 14% e mësimdhënësve të anketuar kanë shkollimin master dhe 6% kanë shkollim postdiplomik.




**Figura 8.** Klasa në të cilën vijojnë mësimin fëmijet e prindërve të anketuar

Nga rezultatet e figures shohim se prindërit e anketuar janë përgjigjur në pyetjen e radhës se në cilën klasë vijojnë mësimin fëmijet e tyre dhe kemi këtë përgjigje, 57% e të anketuarve kanë thënë se fëmijet e tyre vijojnë klasen e IV dhe 43% e prindërve të anketuar kanë thënë se fëmijet e tyre vijojnë mësimin në klasen e V.




**Figura 9.** Metoda e mësimdhënies të cilën prindërit e preferojnë për fëmijet e tyre

Mënyra se si vijojnë mësimin fëmijet ka shumë rëndësi për prindërit dhe këtë na dëshmojnë edhe përgjigjet e prindërve të anketuar ku 96% e tyre kanë deklaruar se për fëmijet e tyre preferojnë vijimin e mësimin në klasë dhe 4% e prindërve të anketuar për fëmijet e tyre e preferojnë mësimin në distancë.




**Figura 10.** Problemet e prindërve për të siguruar paisjet teknologjike qe fëmijet e tyre të ndjekin mësimin në distancë

Sigurimi i paisjeve teknologjike ka qenë sfidë dhe barrë shumë e rëndë për prindërit dhe këtë na e vërteton rezultati nga figura ku 79% e prindërve të anketuar kanë thënë se ka qenë mjaft problem sigurimi i paisjeve teknologjike në mënyrë qe fëmijët e tyre të ndjekin mësimin në distancë dhe 21% e prindërve të anketuar kanë thënë se nuk kanë pasur probleme në sigurimin e paisjeve teknologjike për fëmijet e tyre dhe se ata kanë ndjekur mësimin në distancë pa ndonjë problem.




**Figura 11.** Vështirësitë e fëmijëve në përdorimin e paisjeve teknologjike të cilat mundësojnë mësimin në distancë.

86% e prindërve të anketuar kanë deklaruar se fëmijet e tyre kanë pasur probleme gjatë përdorimit të paisjeve teknologjike gjatë kohes qe kanë vijuar mësimin në distancë dhe 14% e prindërve të anketuar kanë deklaruar se fëmijet e tyre nuk kanë pasur problem gjatë përdorimit të paisjeve teknologjike.




**Figura 12.** Vështirësit e fëmijëve për tu adaptuar me mësimin në distancë sipas përgjigjeve të prindërve.

Prindërit e anketuar kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me pyetjen e radhës se sa kanë pasur vështirësi fëmijet e tyre të adaptohen me mësimin në distancë dhe nga përgjigjet e tyre kemi këtë rezultat, 82% e tyre thonë se fëmijet e tyre kanë pasur vështirësi në adaptim lidhur me mësimin në distancë ndërsa 18% e prindërve të anketuar kanë thënë se fëmijet e tyre nuk kanë pasur vështirësi për tu adaptuar me mësimin në distancë.



**Figura 13.** Vlerësimi i prindërve lidhur me menaxhimin e orës mësimore në distancë nga mësimdhënësi.

Nga të gjithë prindërit e anketuar sa i përket pyetjes së radhës se si e vlerësojnë ata menaxhimin e orës mësimore në distancë nga mësimdhënësit ne e kemi këtë rezultat, 72% e të anketuarve kanë thënë se e vlerësojnë pozitivisht mundin e mësimdhënësve për ta menaxhuar sa më mirë oren mësimore nga distanca dhe 28% e prindërve të anketuar kanë thënë se nuk e vlerësojnë menaxhimin e ores mësimore në distancë nga mësimdhënësit e fëmijeve të tyre.



**Figura 14.** Mendimet e prindërve mbi vlerësimin e fëmijëve nga mësimdhënësit gjatë mësimit në distancë.

78% e prindërve të anketuar janë të pakënaqur me vlerësimin e fëmijëve të tyre nga ana e mësimdhënësve gjatë vijimit të mësimit në distancë ndërsa 22% e prindërve të anketuar kanë thënë se po janë të kënaqur me vlerësimin e fëmijëve të tyre nga ana e mësimdhënësve gjatë vijimit të mësimit në distancë.

### 5.3 Analiza deskriptive e të dhënave demografike të nxënësve


Analiza deskriptive e cila është përdorur për përshkrimin e të dhënave demografike të nxënësve, është paraqitur në Tabelën 3. Të dhënat demografike të 80 nxënësve të anketuar janë shprehur në numër dhe në përqindje.

**Tabela 3.** Analiza deskriptive e të dhënave demografike të nxënësve

<b>GJINIA</b>	<b>N</b>	<b>%</b>	<b>MOSHA</b>	<b>N</b>	<b>%</b>	<b>KLASA NË TË CILEN VIJONI MËSIMIN</b>	<b>N</b>	<b>%</b>
<i>Femër</i>	47	59	9 vjeç	42	52	<i>Klasa IV</i>	44	55
<i>Mashkull</i>	33	41	10 vjeç	38	48	<i>Klasa V</i>	36	45


Nga analiza korrelacionare në Tabelën 3., shohim se sa i përket gjinisë së nxënësve kemi këtë rezultat, 59% e nxënësve të anketuar i përkasin gjinisë femërore dhe 41% gjinisë mashkullore. Moshë e nxënësve të anketuar sipas rezultatit në Tabelën 3., është 52% i takojnë moshës 9 vjeç e dhe 48% i takojnë moshës 10 vjeç. Sa i përket klases në të cilën vijojnë mësimin nxënësit nga tabela kemi këtë rezultat, 55% e nxënësve të anketuar vijojnë klasen e IV dhe 45% e nxënësve të anketuar vijojnë klasen e V.






**Figura 15.** Të dhënat e nxënësve se a e preferojnë më shumë mësimin në klasë apo në distancë.

Nxënësit e anketuar nga klasa e IV dhe klasa e V kanë dhënë këto përgjigje sa i përket pyetjes se a më shumë e preferojnë mësimin në klasë apo mësimin në distancë dhe kemi këto rezultate, 80% e nxënësve kanë thënë se më shumë e preferojnë mësimin në klasë kurse 20% e nxënësve të anketuar kanë thënë se më shumë e preferojnë mësimin në distancë.




**Figura 16.** Problemet e nxënësve me përdorimin e paisjeve teknologjike që mundësojnë mësimin në distancë.

71% e nxënësve të anketuar kanë thënë se po kanë pasur problem me përdorimin e paisjeve teknologjike që mundësojnë mësimin në distancë dhe 29% e nxënësve të anketuar kanë thënë se jo nuk kanë pasur problem me përdorimin e paisjeve teknologjike që mundësojnë mësimin në distancë.




**Figura 17.** Njohuritë e nxënësve për programet që mundësojnë mbajtjen e mësimit në distancë.

Mësimi në distancë është diçka e re tek ne dhe këtë na vërteton rezultati nga figura 17., ku nxënësit e anketuar kanë dhënë përgjigjet e tyre se a kanë pasur më herët njohuri për programet që mundësojnë mbajtjen e mësimit në distancë, 61% e nxënësve të anketuar kanë thënë se jo nuk kanë pasur njohuri më herët për programet që mundësojnë mbajtjen e mësimit në distancë dhe 39% e tyre kanë thënë se po kanë pasur njohuri për programet që mundësojnë mbajtjen e mësimit në distancë.




**Figura 18.** Menaxhimi i ores gjatë mësimit në distancë sfidë për mësimsdhënësit

Nga të dhënat e grafikonit shohim se menaxhimi i ores mësimore në distancë nga mësimsdhënësit është mjaft sfiduese dhe këtë na dëshmon rezultati në figuren 18., ku 61% e nxënësve të anketuar kanë deklaruar se mësimsdhënësit e tyre nuk e kanë menaxhuar mirë oren mësimore gjatë mësimit në distancë dhe 39% e nxënësve të anketuar kanë thënë se mësimsdhënësit e tyre e kanë menaxhuar mirë oren mësimore gjatë mësimit në distancë.




**Figura 19.** Vështirësitë e nxënësve për tu adaptuar me mësimin në distancë.

Adaptimi i nxënësve gjatë mëimit në distancë ka qenë problem mjaft i madhë sepse 66% e nxënësve të anketuar kanë deklaruar se po kanë pasur vështirësi për tu adaptuar me mësimin në distancë kurse 34% e nxënësve të anketuar kanë deklaruar se jo nuk kanë pasur vështirësi për tu adaptuar me mësimin në distancë.



**Figura 20.** Kënaqësia mbi vlerësimin që mësimdhënësit e kanë dhënë për nxënësit e anketuar.

64% e nxënësve të anketuar kanë thënë se nuk janë të kënaqur me vlerësimin që mësimdhënësit e kanë dhënë gjatë mëimit në distancë ndërsa 36% e nxënësve kanë thënë se janë të kënaqur me vlerësimin që mësimdhënësit e kanë dhënë gjatë mëimit në distancë.



**Figura 21.** Nxënësit shprehin dëshirën e tyre mbi mënyrën e ndjekjes së mësimin që ata dëshirojnë.

Nga 80 nxënësit e anketuar 76% e tyre kanë deklaruar se dëshirojnë ta vazhdojnë mësimin në klasë dhe vetëm 24% nga nxënësit e anketuar kanë deklaruar se dëshirojnë të vazhdojnë me mësimin në distancë. Nga të dhënat e figurës 21., shohim se nxënësit në shkollat tona ende e dëshirojnë mësimin në klasë dhe nuk kanë ndonjë preferencë për mësimin në distancë.

#### 5.4 Analiza e besueshmërisë së pyetësorit të mësimit në distancë, prindërve dhe nxënësve

Në vazhdim po japim analizën e besueshmërisë së pyetësorit të aplikuar në këtë punim masteri.

**Tabela 4.** Cronbach's Alpha

##### Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	N of Items
.618	10

Tabela 4. Pasqyron konsistencën e brendshme të pyetësorit që ka rezultuar sipas analizës së alpha crombahut mbi besueshmërinë e pyetësorit rezulton .618 një besueshmëri e lartë e pyetësorit.

**Tabela 5.** Menaxhimi i mësimit në distancë dallon shumë nga menaxhimi i mësimit në klasë.

Correlations			
		1. Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet mësimit në klasë dhe mësimit në distancë?	2. Cilat janë opinionet e mësimit në distancë për specifikat e organizimit të mësimit në distancë?
1. Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet mësimit në klasë dhe mësimit në distancë?	Pearson Correlation	1	„.649”
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	180	180
2. Cilat janë opinionet e mësimit në distancë për specifikat e organizimit të mësimit në distancë?	Pearson Correlation	„.649”	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	180	180

\*\* . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Tabela 5. Paraqet të dhënat për hipotezën e parë të hulumtimit e cila është: Menaxhimi i mësimit në distancë dallon shumë nga menaxhimi i mësimit në klasë. Kjo hipotezë është testuar përmes analizës së korrelacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar se ekziston një ndërlidhje pozitive e cila na vërteton se ekziston një dallim i madh në mes të menaxhimit të mësimit në klasë krahasuar me menaxhimin e mësimit në distancë dhe kjo është vërtetuar me një vlerë prej  $r = .649^{**}$  që tregon një ndërlidhje të fortë pozitive në mes dy këtyre dy variablave.

**Tabela 6.** Mësimdhënësit nuk janë të aftësuar mjaftueshëm para shërbimit për zbatimin e mësimit në distancë.

Correlations			
		1. Mësimdhënësit nuk janë të aftësuar mjaftueshëm para shërbimit për zhvillimin e mësimit në distancë?	2. Cilat janë dallimet dhe karakteristikat e mësimdhënies në klasë dhe mësimdhënies në distancë?
1. Mësimdhënësit nuk janë të aftësuar mjaftueshëm para shërbimit për zhvillimin e mësimit në distancë?	Pearson Correlation	1	„.672”
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	180	180
2. Cilat janë dallimet dhe karakteristikat e mësimdhënies në klasë dhe mësimdhënies në distancë?	Pearson Correlation	„.672”	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	180	180
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).			

Tabela 6. Na ofron të dhëna të sakta për hipotezën e dytë të hulumtimit dhe e cila është: Mësimdhënësit nuk janë të aftësuar mjaftueshëm para shërbimit për zbatimin e mësimin në distancë. Kjo hipotezë është testuar përmes analizës së korrelacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar se ekziston një ndërlidhje pozitive në mes të aftësisë të shërbimit dhe zbatimit të mësimin në distancë dhe kjo është vërtetuar me një vlerë prej  $r = .672^{**}$  që tregon një ndërlidhje të fortë pozitive në mes dy këtyre dy variablave.

**Tabela 7.** Nxënësve iu mungojnë shkathtësitë e nevojshme për zbatimin e mësimin në distancë.

Correlations			
		<b>3.</b> Nxënësve iu mungojnë shkathtësitë e nevojshme për zbatimin e mësimin në distancë?	<b>4.</b> Cilat janë dallimet dhe karakteristikat e mësimdhënies në klasë dhe mësimdhënies në distancë?
<b>3.</b> Nxënësve iu mungojnë shkathtësitë e nevojshme për zbatimin e mësimin në distancë?	Pearson Correlation	1	„.711”
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	180	180
<b>4.</b> Cilat janë dallimet dhe karakteristikat e mësimdhënies në klasë dhe mësimdhënies në distancë?	Pearson Correlation	„.711”	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	180	180
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).			

Tabela 7. Sa iu mungojnë nxënësve shkathtësitë e nevojshme për zbatimin e mësimin në distancë, këto të dhëna i marrim nga rezultati i tabelës ku hipoteza e tretë e hulumtimit është: Nxënësve iu mungojnë shkathtësitë e nevojshme për zbatimin e mësimin në distancë. Kjo hipotezë është testuar përmes analizës së korrelacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar se ekziston një ndërlidhje pozitive në mes shkathtësisë dhe zbatimit të mësimin në distancë dhe kjo është vërtetuar me një vlerë prej  $r = .711^{**}$  që tregon një ndërlidhje të fortë pozitive në mes dy këtyre dy variablave.

**Tabela 8.** Analiza e One-Way Anova mbi dallimet në mes të shkollave lidhur me vendbanimin urban dhe rural

Descriptives						
Sum Mësimi në klasë dhe mësimi në distancë						
	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error	95% Confidence Interval For Mean	
					Lower Bound	Upper Bound
Mësimi në klasë	112	17.8220	4.41762	,41194	15.6796	17.3117
Mësimi në distancë	68	16.0598	3.94857	,36505	15.3368	16.7828
<b>Total</b>	180	16.7971	4.26104	,22776	16.3492	17.2451

ANOVA					
Sum Mësimi në klasë dhe mësimi në distancë					
	Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	198.005	2	99.003	5.596	.004
Within Groups	6138.592	178	17.690		
<b>Total</b>	6336.597	180			

Tabela 8. Nga rezultatet e tabelës shohim se dallimet në mes të mësimit në klasë dhe mësimit në distancë të matura me programin One Way Anova, rezultojnë që kanë një dallueshmëri shumë të madhe mes tyre me një mesatare  $M = 17.82$ , kjo analizë është matur me një besueshmëri prej 95% dhe signifikanca e saj është  $p > 0.04$ .



## VI DISKUTIMI

Në këtë kapitull janë shtjelluar diskutimet mbi rezultatet e përfituara nga ky studim, duke treguar se a janë vërtetuar apo hedhur poshtë hipotezat e ngritura. Mësimi në distancë/e-mësimi është një sfidë e re për drejtuesit e shkollave, për mësimdhënësit, por edhe për nxënësit dhe prindërit.

Organizimi dhe menaxhimi i mjedisit të klasës sikurse është theksuar edhe më lartë përbën padyshim një ndër problematikat e sistemit tonë arsimor fillor. Të gjendur përballë kësaj situatë shpesh mësimdhënësit hasin vështirësi organizative dhe menaxhuese të cilat në një mënyrë apo tjetrën çënojnë orën e mësimit duke ndikuar konsiderueshëm në arritjet e nxënësve.

Trajtimi që i bën ky punim çështjes së oraganizimit dhe menaxhimit të mësimit në klasë dhe në distancë nuk fokusohet thjesht në organizimin dhe menaxhimin e mësimit por trajton elementin kohë, hapësirën fizike, sjelljen e individit, përdorimin e teknologjisë dhe ndikimin e saj në arritjen e një menaxhimi të suksesshëm, etj. Të gjithë këto elementë në kompleksitetin e tyre na ofrojnë një panoramë të gjerë të kësaj tematike, të cilat do ti paraqesim në komentimin e hipotezave të ngritura në këtë hulumtim.

Bazuar në reflektimet e mësimdhënësve dhe nxënësve, mund të konstatohet se të mësuarit në shtëpi është i pranueshëm për ta (edhe pse problemet kanë qenë të mëdha) dhe se kjo për rrethanat aktuale ishte zgjidhja më e mirë dhe se janë në përpjekje të vazhdueshme për avancim të mëtutjeshëm. Kjo dëshmon se angazhimi dhe aktivizimi i madh i mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve, ka mundësuar që në masë të konsiderueshme të kompensohet mësimi i shkollës, mirëpo duke pasur kujdes në menaxhimin e situatës, organizimin e mësimit dhe motivimin e nxënësve për mësim.

Në vazhdim paraqesim vërtetimin e hipotezave duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit.

Hipoteza 1. Menaxhimi i mësimit në distancë dallon shumë nga menaxhimi i mësimit në klasë.

Hipoteza e parë që shtjellon edhe çështjen kryesore të këtij studimi, synonte të vërtetonte që menaxhimi i mësimit në distancë dallon shumë nga menaxhimi i mësimit në klasë. Kjo hipotezë është testuar përmes analizës së korrelacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar se ekziston një ndërlidhje pozitive e cila na vërteton se ekziston një dallim i madh në mes të menaxhimit të mësimit në klasë krahasuar me menaxhimin e mësimit në distancë dhe kjo është vërtetuar me një vlerë prej  $r = .649^{**}$  që tregon një ndërlidhje të fortë pozitive në mes dy këtyre dy variablave.

Hipoteza 2. Mësimdhënësit nuk janë të aftësuar mjaftueshëm para shërbimit për zbatimin e mësimit në distancë.

Hipoteza e dytë synonte të vërtetonte se a janë mjaftueshëm të aftësuar mësimdhënësit për zbatimin e mësimit në distancë dhe kjo hipotezë është testuar përmes analizës së korrelacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar se ekziston një ndërlidhje pozitive në mes të aftësisë të shërbimit dhe zbatimit të mësimit në distancë dhe kjo është vërtetuar me një vlerë prej  $r = .672^{**}$  që tregon një ndërlidhje të fortë pozitive në mes dy këtyre dy variablave.

Hipoteza 3. Nxënësve iu mungojnë shkathtësitë e nevojshme për zbatimin e mësimit në distancë.

Hipoteza e tretë na ofron detaje rreth problemit të nxënësve se sa rëndësi ka shkaathtësia në zbatimin e mësimit në distancë dhe këto të dhëna i marrim nga rezultati i tabelës ku vërtetojmë se nxënësve iu mungojnë shkathtësitë e nevojshme për zbatimin e mësimit në distancë. Kjo hipotezë është testuar përmes analizës së korrelacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar se ekziston një ndërlidhje pozitive në mes shkathtësisë dhe zbatimit të mësimit në distancë dhe kjo është vërtetuar me një vlerë prej  $r = .711^{**}$  që tregon një ndërlidhje të fortë pozitive në mes këtyre dy variablave.

## VII PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Realizimi i këtij studimi më bëri të mundur që nga afër të shoh veçantitë e organizimit dhe menaxhimi i mësimit në klasë dhe mësimit në distancë në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet, gjithashtu më mundësoi që nga afër të vërej rëndësinë që ka organizimi dhe menaxhimi i mësimit si në klasë poashtu edhe në distancë në funksion të mësimit të fëmijëve.

Nga analizat e realizuara në kapitullin paraprak, nëpërmjet programit kompjuterik SPSS version 23, janë nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat përfshihen në këtë kapitull. Rekomandimet u drejtohen institucioneve arsimore, të cilat drejtpërdrejt përfshihen në përpilimin e planprogrameve dhe politikave për ndryshime, ndërhyrje dhe mbikëqyrje të të gjitha punëve që bëhen nëpër shkolla fillore publike dhe private në vendin tonë.

Padyshim që ka shumë dallim në organizimin dhe menaxhimin e mësimit në klasë dhe mësimit në distancë dhe këtë na e dëshmuar edhe rezultatet e studimit.

Nga ky studim kemi arritur në përfundim se:

- Të mësuarit nuk fillon dhe nuk mbaron gjatë një ore mësimore. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka ndikuar që të paraqiten kërkesa të reja dhe ndërhyrje të shpejta në metodologjitë e të nxënësve.
- Mësimit në distancë gjithnjë ka qenë sfidë dhe si e tillë po vazhdon të mbetet në të mësuarit në Kosovë. Sfidë e studimit ishte gjetja e faktorëve, të cilët ndikojnë në organizimin dhe menaxhimin e orës mësimore në klasë dhe në distancë. Prandaj, organizimi dhe menaxhimi i mësimit në distancë që në fillim të këtij hulumtimi bëhet variabël e varur. Varshmëria e saj lidhet me variabla të ndryshme të cilat njihen si të pavarura: *mosha, përvoja e punës e mësimit në distancë, përdorimi i pajisjeve teknologjike, qasja në internet, e-mail, komunikimi, interneti për ngritje profesionale, platforma online dhe vlerësimi i nxënësve.*

### *Rekomandime*

- të mbahen sa më shumë trajnime adekuate dhe të vazhdueshme për mësuesin, të cilët do të përgatiteshin në mënyrën më të mirë për organizimin dhe menaxhimin e mësimit në distancë,
- përgatitjet e infrastrukturës adekuate, e cila i plotëson kriteret e të nxënësve në distancë,
- orari fleksibil për nxënës që ata të mësojnë kur atyre u konvenon dhe jo kur e kanë orarin e caktuar që për ta mund të jetë si diçka e imponueshme,
- fushatë informuese për prindërit që të binden se ky mësimi në distancë është përdorur në vendet e rajonit dhe të BE-së,
- fillimi me mësim të kombinuar për të arritur deri te pavarësia e plotë e mësimit në distancë.

Diskutimet, studimet, analizat, konkluzionet, nevojat dhe kërkesat për të nxënës nga mësimi në distancë nuk janë domosdoshmërisht faktorë vendimtarë, të cilët do t'i çonin institucionet arsimore publike apo jopublike deri te vendimmarrja për transformim të tyre në këtë lloj të të nxënësve. Kjo kërkon kohë dhe përgatitje adekuate profesionale për të qenë të gatshëm me implementimin e të mësimit nga distanca. Vendimet e shpejta dhe pa u cekur përgjegjësia në rast të dështimit të një sistemi të ri arsimor ka sjellë deri te dështimet e shumta që janë bërë në ndërhyrjet e shumta gjatë këtyre viteve dhe sidomos në dy vitet e fundit me paraqitjen e pandemisë Covid-19 kur mësimi në distancë është bërë i obliguar.

Shoqëria kosovare është stërngopur me dështime të shumta në arsim, ndërsa arsimi është shtylla themelore e një shoqërie njerëzore. Ky studim e ka pasur pikërisht qëllimin që t'i nxjerrë në fund konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat do të jenë ndihmesë për qeveritarët e sotëm dhe ata të cilët pasojnë. Të mësuarit në distancë do të mund të implementohet edhe në institucionet e Kosovës sikur të bëhet ndërhyrja e nevojshme dhe adekuate në të gjitha pikat kyçe të arsimit.

## **7.1 Aspekti etik**

Për grumbullimin e literaturës dhe të dhënave për këtë hulumtim është respektuar etika hulumtuese. Të dhënat që janë mbledhur kanë qenë konfidenciale. Ato janë përdorur vetëm për qëllimin e këtij hulumtimi dhe nuk janë publikuar apo parë nga dikush i paautorizuar. Fillimisht, është siguruar leja nga DKA në Vushtrri, përmes një formulari pajtimi ku u firmos nga drejtorët e të gjitha shkollave dhe nga mësimdhënësit e klasave pjesëmarrëse për të mundësuar realizimin e pyetësorit me vet mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit e këtyre shkollave. Të gjithë këtyre u është treguar se hulumtimi është vetëm për qëllime të studimeve dhe për asnjë qëllim tjetër. Pjesëmarrja në plotësimin e pyetësorit ka qenë e vullnetshme dhe asnjë pjesëmarrësi nuk i është imponuar plotësimi i tij.

## **7.2 Kufizimet në hulumtim**

Ky hulumtim ka kufizime për sa i përket mungesës së literaturës dhe kërkimeve shkencore në Kosovë, të cilat lidhen edhe me mungesën e analizës statistikore sasiore për veçantitë e organizimit dhe menaxhimit të mësimin në klasë dhe në distancë në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet. Gjatë hulumtimit po ashtu është vërejtur se mungon literaturë në gjuhën shqipe, e cila merret me studime të thelluara për t'i motivuar nxënësit për t'i ndjekur mësimet nga distanca.

Në Kosovë, më heret kemi pasur njohuri për organizimin dhe menaxhimin e mësimin në klasë por nuk kemi pasur shumë njohuri për organizimin dhe menaxhimin e mësimin në distancë. Që të arrihet pavarësi e plotë e të nxënit në distancë veprojnë shumë faktorë, të cilët janë të vështirë për t'u plotësuar, si infrastruktura, kuadrot arsimore të papërgatitura për këtë metodë të të nxënit, pranimi i rrezikut për dështim nga prindërit, përgatitja e nxënësve, kostoja e lartë për shkollat dhe kuadrot tjera profesionale etj.

## REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Ahmeti, B. (2012). *Baza te informatikes dhe teknologjise informatike*. Prishtine.
- Ardijana, I. & Ajrullai, A. (2020). *Koncept per zhvillimin e sistemit per arsimin ne distance*.
- Carol.C. (2010). *Winning Strategies for Classroom Managment. The greatest sign of succes for a teacher...is to be able to say*. USA: ASCD.
- Cattagni, A & E, Farris. (2009). *Computer aided learning in the . United States*.
- Charles, M.C. (2015). *Senter Building Classroom Discipline. Chapter 7. 8th Edition*. Usa: Pearson.
- De Beni. M. (2013). *Educare all altruismo- Erikson*.
- Gaebel, Michael. (2014). *E-learning in european higher education institutions*. Bruksel: Belgjikë.
- Gjokutaj, M. & Kadriu, D. (2016). *Fjalor termash në edukim*. Prishtinë: Shtëpia Botuese "Dukagjini".
- Haliti, Sh. (2007). *Në kërkim të pedagogjisë reformuese*.
- Haloqi. A. (2010). *Mardhëniat në klasë*. Tiranë: Shtëpia botuese e Librit Universitar.
- <https://emesimi.rks-gov.net>. (a.d).
- <https://emesimi.rks-gov.net/shq/>. (2020, tetor).
- Littlefield. J. (2021). *Dallimi midis të mësuarit sinkrom dhe asinkrom në distancë*.
- MASH. (2020). *Udhëzues për metodikën e mësimit në distancë në shkollen fillore dhe të mesme*.

- MASHT. (2016). Ministria e Arsimit, e Shkences dhe Teknologjisë, "Plani strategjik i organizimit të arsimit në Kosovë".
- MASHT. (2020). *Organizimi i mësimit në distancë në Kosovë*. Prishtine.
- MASHT. (2020). UDHËZUES PËR VLERËSIMIN.
- MASHTI. (2020). *Ministria e Arsimit, e Shkences dhe Teknologjisë "Udhëzuesi për vlersimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë"*. Gjetur në Mësimi në distancë/ E-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë në rrethana e krijuara nga Covid-19 .
- Mattheis Carmen. (2012). *Shkolla e mirë, Zhvillimi i Kapaciteteve në Udhëheqjen 76*. Tiranë, Shqipëri.
- Mc Queen, Theona. (2012). *Essential of Classroom Managment and Discipline*. USA: Harper Colin Publisher.
- Murati, Xh. (2012). *"Didaktika" (Metodologjia e mësimdhënies)*. Tetovë.
- Musai, B. (2013). *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: Pegi.
- Musai, B. (2017). *Metodologji e Mesimdhënies*. Tiranë.
- Nikoleta, M. (2013). *Vlerësimi në Arsim*. Tiranë.
- Osmani Nexhmie. (2015). *2010 Reformat ne arsimin e Kosovës 2015*.
- Osmani. S. (2016). *Veshtrime mbi studime e botime per shkollen, shkencen dhe kulturen. Shkrime per Ciklin e Ulet*. Tiranë.
- Person, L. (2011). *Managment-the process of controlling or managing something*. UK: Macmillan English Dicitonary for Advanced Learners. Second Edition.
- Pink H. Daniel. (2014). *Social Learning*. San Francisco.

- Platform-e-learning. (2020, May 12). <https://www.techopedia.com/definition/3411/platform-computing#what-does-platform-mean>. Gjetur në <https://www.techopedia.com/definition/3411/platform-computing#what-does-platform-mean>
- Qafa, A. (2014). *Prof, Shefik Osmani per karakterin edukativ te teksteve per nxenesit e ciklit te ulet*. Tirane.
- Robbins P.Stephen. (2014). *Bazat e menaxhimiti*. Tiranë, Shqipëri.
- Rothstein, C. & Elies, T. (2015). *Managing Diverse Classrooms, How to Build on Students' Cultural Sternghths*. USA: ASCD.
- Scarlett, W. (2015). *The Sage Encyclopadia of Classroom Managment*. USA: Sage Publications Inc.
- Shaarma, Y, K. & Sharma, M. (2007). *Educational Technology and Managment, Knishka Publishers, Distributors, . New Delphi*.
- Skenderi Skender. (2017). *Interneti*. Prishtinë, Kosovë.
- Tafari, V & Valva , L. (2016). *Teaching Skills and Practices*. Tiranë: Pegi.
- Technology&Digital Platforms-Learnlife. (2020, 07 23). <https://www.learnlife.com/technology-digital-platforms>. Gjetur në <https://www.learnlife.com/technology-digital-platforms>.
- Techradar. (2021, septembre 21). <https://www.weareteachers.com>. Gjetur në Best online learning platforms of 2021/Tech Radar.
- Tedesco, A & E, Fathi. (2014). *Theory and practise of online learning, Athabasca University*. Creative Commons.
- The Cmpbell Collaboration. (2011). *Teacher Classroom Managment Practices:.* Campbell: USA:.



- The Peace Corps. (2020). *Classroom Managment*. Govenment Printing Office: USA.
- Vangjeli Gjergji. (2016). *Edukimi për shoqërinë 1*. Tiranë, Shqipëri.
- Vojka-Ismajli, H. (2012). *Teknologjia mësimore dhe të menduarit kritik*. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Walters, J. & Shelly Frey. (2017). *Managing Classroom Behaviour and Siscipline*. USA; Shell Education.
- Wright, T. (2015). *Classroom Managment in Language Education*. UK: Palgrave Macmillan.
- Zajazi, T. (2008). *Metodologji të Mësimdhënies dhe Mësimnxënies*. Shkup, Maqedoni.
- Zekaj, Xhevdet & Kozma Grillo. (2013). *Fjalori i Pedagogjisë*. Tiranë: Shtypshkronja e Universitetit "Kristal", fq. 227.
- Zhuro Dunja. (2014). *mësimi në distancë nëpërmjet video konferencës në relacionin:shf."*Majstora Radovana Trogir-pro Veli Drvenik. Trogir, Kroaci.
- Zylfiu. N. (2002). *Didaktika*. Prishtinë.

## SHTOJCA – 1: Pytësori për mësimdhënësit

### Të nderuar mësimdhënëses!

Në kuadrin e një studimi për veçantitë e organizimit dhe menaxhimit të mësimin në klasë dhe mësimin në distancë në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet, kam nevojë për ndihmën dhe mendimin tuaj. Gjithashtu ju sigurojë që ky pyetësor më duhet mua, vetëm për hulumtimet e mia në studimet master. Shpresoj që të kem ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj dhe poashtu ju sigurojë që pyetësori është anonim dhe se asnjë shënim nga ai nuk lidhet me shënimet tuaja personale. Plotësimi i pyetësorit do të ju marrë kohë përafërsisht 10-15 minuta. Fillimisht do të kërkoja pëlqimin tuaj për pjesëmarrje.

**Ju falenderojë paraprakisht për pjesëmarrjen tuaj!**

### I- Të dhënat bio-sociale

#### 1. Gjinia:

Mashkull

Femër

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

#### 2. Moshë:

deri në 30 vjeç

31-40 vjeç

41-50 vjeç

Mbi 51 vjeç

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

#### 3. Niveli i arsimimit:

Studime bachelor

Studime master

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

#### 4. Vendi i banimit:

Urban

Rural

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

#### 5. Në cilën klasë jepni mësim?

Klasen I

Klasen II

Klasen III

Klasen IV

Klasen V

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

**II-** Deklaratat në vijim lidhen me perceptimet tuaja për organizimin e mësimit në distancë.

1- Pajtohem plotësishtë

3- I/e pa përcaktuar

5- Nuk pajtohem fare

2- Pajtohem

4- Nuk pajtohem

		1	2	3	4	5
1.	A e preferoni mësimin në klasë.					
2.	A e preferoni mësimin në distancë.					
3.	A e keni më të lehtë menaxhimin e ores në klasë.					
4.	A e keni më të lehtë menaxhimin e ores në distancë.					
5.	A keni pasur vështirësi në përdorimin e mjeteve teknologjike me të cilat keni punar në mësimin në distancë					
6.	A keni njohuri të mjaftueshme rreth programeve qe mundësojnë mësimin në distancë.					
7.	A keni ndonjë nxënës qe nuk ka ndjekur mësimin në distancë.					

***Faleminderit të gjithëve!***

## SHTOJCA – 2: Pytësori për prindërit

### Të nderuar prinder!

Në kuadrin e një studimi për veçantitë e organizimit dhe menaxhimit të mësimit në klasë dhe mësimit në distancë në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet, kam nevojë për ndihmën dhe mendimin tuaj. Gjithashtu ju sigurojë që ky pyetësor më duhet mua, vetëm për hulumtimet e mia në studimet master. Shpresoj që të kem ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj dhe poashtu ju sigurojë që pyetësori është anonim dhe se asnjë shënim nga ai nuk lidhet me shënimet tuaja personale. Plotësimi i pyetësorit do të ju marrë kohë përafërsisht 10-15 minuta. Fillimisht do të kërkoja pëlqimin tuaj për pjesëmarrje.

**Ju falenderoj paraprakisht për pjesëmarrjen tuaj!**

### I- Të dhënat bio-sociale

#### 1. Gjinia juaj?

Mashkull

Femër

(Bëni tik √ në katrorin përkatës)

#### 4. Cili është vendbanimi juaj?

Urban

Rural

(Bëni tik √ në katrorin përkatës)

#### 2. Mosha juaj?

Më pak se 30 vjeç

31-40 vjeç

41-50 vjeç

Mbi 51 vjeç

(Bëni tik √ në katrorin përkatës)

#### 5. Në cilen klasë vijon mësimin fëmija juaj?

Klasen e IV

Klasen e V

(Bëni tik √ në katrorin përkatës)

#### 3. Edukimi juaj?

Studime bachelor

Studime master

Doktoraturë

(Bëni tik √ në katrorin përkatës)

#### 6. Cilen metodë të mësimit preferoni më shumë për fëmijën tuaj?

Mësimin në klasë

Mësimin në distancë

(Bëni tik √ në katrorin përkatës)

**II-** Deklaratat në vijim lidhen me perceptimet tuaja për organizimin e mësimit në distancë.

1- Pajtohem plotësishtë

3- I/e pa përcaktuar

5- Nuk pajtohem fare

2- Pajtohem

4- Nuk pajtohem

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

		1	2	3	4	5
1.	A keni pasur problem me sigurimin e paisjeve të nevojshme për të ndjekur fëmijet tuaj mësimin në distancë.					
2.	A kanë pasur vështirësi fëmijët tuaj për ti përdorur mjetet teknologjike të cilat ju kanë mundësuar vijimin e mësimit në distancë.					
3.	A ka pasur vështirësi fëmija juaj të adaptohet me mësimin në distancë.					
4.	Si e vlerësoni ju si prind menaxhimin e orës mësimore në distancë nga mësimdhënësi.					
5.	A jeni të kënaqur me vlerësimin e fëmijëve tuaj gjatë mësimit në distancë.					

***Faleminderit të gjithëve!***

## SHTOJCA – 3: Pytësori për nxënësit

### Të nderuar nxënës!

Në kuadrin e një studimi për veçantitë e organizimit dhe menaxhimit të mësimin në klasë dhe mësimin në distancë në shkollat fillore-ngjajshmëritë dhe dallimet, kam nevojë për ndihmën dhe mendimin tuaj. Gjithashtu ju sigurojë që ky pyetësor më duhet mua, vetëm për hulumtimet e mia në studimet master. Shpresoj që të kem ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj dhe poashtu ju sigurojë që pyetësori është anonim dhe se asnjë shënim nga ai nuk lidhet me shënimet tuaja personale. Plotësimi i pyetësorit do të ju marrë kohë përafërsisht 10-15 minuta. Fillimisht do të kërkoja pëlqimin tuaj për pjesëmarrje.

**Ju falenderojë paraprakisht për pjesëmarrjen tuaj!**

### I- Të dhënat bio-sociale

#### 1. Gjinia:

Mashkull

Femër

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

#### 2. Moshë:

9 vjeç

10 vjeç

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

#### 3. Në cilën klasë vijoni mësimin:

Klasen IV

Klasen V

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

#### 4. A e pëlqeni më shumë mësimin në klasë apo në distancë?

Mësimin në klasë

Mësimin në distancë

(Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës)

**II-** Deklaratat në vijim lidhen me perceptimet tuaja për organizimin e mësimit në distancë.

1- Pajtohem plotësishtë

3- I/e pa përcaktuar

5- Nuk pajtohem fare

2- Pajtohem

4- Nuk pajtohem

		1	2	3	4	5
1.	A keni problem në përdorimin e paisjeve teknologjike që mundësojnë mësimin në distancë.					
2.	A keni pasur njohuri më heret për programet që mundësojnë mbajtjen e mësimit në distancë.					
3.	A mendoni që mësime dhënësit kanë arritur ta menaxhojnë mirë orën gjatë mësimit në distancë.					
4.	A keni pasur vështirësi të adaptoheni me mësimin në distancë.					
5.	A jeni të kënaqur me vlerësimin që mësime dhënësit e kanë dhënë për juve gjatë mësimit në distancë.					
6.	A do të dëshironi më shumë të vazhdoni me mësimin në klasë apo me mësimin në distancë.					

***Faleminderit të gjithëve!***